



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 55 prot.

Shkodër, më 06.01.2022

V E N D I M

Nr. 3, datë 06.01.2022

“Për miratimin e raportit të cilësisë së brendshme për vitin akademik 2020-2021”

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 38, pika 1, germa j; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa h, Neni 24, pika, 2, Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim Raportin e cilësisë së brendshme për vitin akademik 2020-2021, në mbledhjen e tij të datës 06.01.2022

Vendosi:

1. Të miratojë Raportin e cilësisë së brendshme për vitin akademik 2020-2021 (materiali bashkangjitur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Prof. dr. **Simona ÇOLEMI**



UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ
GURAKUQI”

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT 2020-2021







DHJETOR 2021



UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT 2020-2021

GRUPI I VETËVLERËSIMIT

1. Prof. as.dr.Angjelina Nenshati	Kryetar	
2. Msc.Nikoleta Frroku	Anëtare	
3. Dr. Aurora Dibra	Anëtare	
4. Msc.Diana Kastrati	Anëtare	
5. Prof.as.dr. Jozef Bushati	Anëtar(Ekspert i jashtëm)	
6. Orseda Vathej	Anëtare (Studente)	

Përmbajtja

1. HYRJE NË PROCESIN E VETËVLERËSIMIT.....	4
2. HISTORIKU I UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”.....	5
2.1 Rreth universitetit.....	5
2.2 Organigrama e USH-së dhe historiku i fakulteteve.....	6
2.3 Akreditimi i USH-së 2020.....	21
3.VETËVLERËSIMI.....	23
<u>3.1</u> – FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT.....	23
<u>3.2</u> – FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET.....	29
<u>3.3</u> – FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA.....	36
<u>3.4</u> FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KËRKIMI.....	42
<u>3.5</u> – FUSHAT E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE.....	48
Përfundimet dhe vlerësimi i përgjithshëm.....	54
Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së.....	64

Shkurtime

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
LAL	Ligji për Arsimin e Lartë
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
USH	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
ILP	Instituti i Lartë Pedagogjik
BUSH	Biblioteka e Universitetit të Shkodrës
AMS	ASCAL Management System
FSHSH	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
FSHE	Fakulteti i Shkencave të Edukimit
FE	Fakulteti Ekonomik
FD	Fakulteti i Drejtësisë
FGJH	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
FSHN	Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Lista e tabelave

Tab. 1: Skeda informuese për Universitetin “Luigj Gurakuqi”.....	5
Tab. 2: Organigrama.....	6
Tab. 3: Skeda informuese për FSHN.....	9
Tab. 4: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHN.....	9
Tab. 5: Skeda informuese për FSHE.....	11
Tab. 6: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHE.....	11
Tab. 7: Skeda informuese për FGJH.....	13
Tab. 8: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FGJH.....	14
Tab. 9: Skeda informuese për FE.....	15
Tab. 10: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FE.....	16
Tab. 11: Skeda informuese për FD.....	18
Tab. 12: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FD.....	18
Tab. 13: Skeda informuese për FSHSH.....	19
Tab. 14: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHSH.....	20

1. Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit

Duke u bazuar në nenin 130 të ligjit nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, statutin e USH-së, si dhe në “Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë” miratuar me VKM nr.531, datë 11.09.2018, është krijuar grupi për vlerësimin e brendshëm të USH-së. Grupi i vetëvlerësimit përbëhet nga 4(katër) anëtarë të Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve të USH-së, një ekspert i jashtëm (ish-pedagog i USH-së si dhe Koordinatori i parë i USH-së për akreditimin) dhe një studente. Ky raport ka për qëllim të krijojë një tablo të qartë të IAL-së në lidhje me 5(pesë) fushat kryesore:

- Organizimi dhe menaxhimi i institucionit
- Burimet
- Kurrikula
- Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi
- Studentët dhe mbështetja e tyre

2. Historiku i Universiteti të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

2.1 Rreth universitetit

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (USH) është Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IPAL) në RSH, veprimtaria e të cilit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në ligjin nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Fillimisht është hapur me 2 shtator 1957 si Instituti i Lartë Pedagogjik 2-vjeçar i Shkodrës, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.150, datë 18.04.1957. Gjatë periudhës 1970–1971, Instituti i Lartë Pedagogjik, kaloi nga afati i studimit 2-vjeçar në atë 3-vjeçar dhe në vitin shkollor 1982-1983, kaloi nga sistemi 3-vjeçar në atë 4-vjeçar. Kalimi në sistemin 4-vjeçar do të përbënte një hap të rëndësishëm për ngritjen e punës mësimore-shkencore dhe edukative të këtij institucioni. Aspekt i rëndësishëm gjatë kësaj periudhe ishte edhe rritja e numrit të pedagogëve që u shoqërua me rritjen e katedrave. Gjatë viteve 1957-1991, Instituti i Lartë Pedagogjik në Shkodër, ka qenë qendra kryesore e përgatitjes së mësuesve për arsimin 8-vjeçar, ku janë diplomuar 9 586 mësues, pra, rreth ¼ e numrit të arsimtarëve që kishte Shqipëria në ato vite. Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 28.05.1991 mori statusin ligjor Universitet, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. USH-ja është person juridik publik që financohet nga Buxheti i Shtetit ose vetëfinancohet nga burime të tjera të ligjshme. Aktualisht ky Universitet është i organizuar në 6 fakultete dhe 21 departamente dhe ofron 3 cikle studimi : *cikli i parë i studimeve “Bachelor”, cikli i dytë i studimeve “Master Profesional” ose “Master Shkencor” dhe cikli i tretë “Doktoraturë”*. Sot, USH-ja është ndër universitetet më të mëdha në vend, në të cilin studiojnë studentë nga rrethe të ndryshme të vendit, kryesisht nga Veriu i Shqipërisë, por edhe nga trevat shqiptare, si nga Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia. Ky Universitet ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet.

Tab.1: Skeda informuese për Universitetin “Luigj Gurakuqi”


EMRI I INSTITUCIONIT	UNIVERSITETI “LUIGJ GURAKUQI”
Adresa:	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Rektorat <i>Sheshi 2 Prilli</i> , Shkodër, Albania P.O.BOX 4001
Kontakt:	Email-info@unishk.edu.al Telefon: +355 (22) 800 651 Website: www.unishk.edu.al
Rektor	Prof. dr. Suzana Golemi Email-suzana.golemi@unishk.edu.al
Licensuar:	VKM Nr. 150, datë 18.04.1957 si Institut i Lartë Pedagogjik
Statusi ligjor aktual:	VKM Nr.124, datë 28.05.1991 si Universiteti “Luigj Gurakuqi”
Akredituar:	Vendim i ASCAL, Nr.70, datë 21.09.2017 Vendim i ASCAL Nr. 03, datë 24.01.2020

Fakultetet	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës 2. Fakulteti i Shkencave të Edukimit 3. Fakulteti i Drejtësisë 4. Fakulteti i Shkencave Shoqërore 5. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja 6. Fakulteti Ekonomik
Ciklet e studimit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bachelor 2. Master Shkencor, Master Profesional 3. Doktoraturë

2.2 Organigrama e USH-së dhe historiku i fakulteteve

Struktura organizative e USH-së është e publikuar edhe në faqen web të Universitetit (Ref.[link](#)). Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” përbëhet nga 6 fakultete dhe 21 departamente:

Tab.2: Organigrama e USH-së



❖ Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Fakulteti i Shkencave të Natyrës si njësi kryesore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” e nisi veprimtarinë e vet mësimore dhe shkencore me themelimin e Institutit të Lartë Pedagogjik, më 02 shtator 1957. Në këtë vit u hapën degët Matematikë-Fizikë dhe Biologji-Gjeografi si programe studimi 2-vjeçare. Në vitin 1970, degët e studimit të ILP-së patën një ristrukturim dhe kohëzgjatja e studimeve u shtri në 3 vite akademike. Dega Biologji-Gjeografi u rikonceptua duke krijuar dy degë të ndryshme: Biologji-Kimi dhe Histori-Gjeografi. Në vitin 1991, fakulteti merr emrin që ka edhe sot, Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Dega e Matematikës dhe dega e Fizikës ndahen si degë të veçanta. Aktualisht FSHN-ja, ka në përbërje si njësi bazë katër departamente dhe Qendrën e Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës.

Misioni. Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka si mision përgatitjen dhe formimin cilësor të studentëve në të gjitha ciklet e studimit si dhe kërkimin shkencor në fushat përkatëse, në mënyrë që të shfrytëzojnë burimet dhe kapacitetet e vendit në përputhje të plotë me strategjinë dhe perspektivën e zhvillimit. Rezultatet e frytshme të bashkëpunimit tonë me institucionet e mirënjohura arsimore në Evropë dhe SHBA, japin sigurinë e plotë të një perspektive të qartë të fakultetit tonë.

Politika e Cilësisë: Fakulteti i Shkencave të Natyrës u ofron studentëve mundësinë të studiojnë dhe të punojnë me një staf akademik të përkushtuar dhe u ofron programe mësimore bashkëkohore me nivel të lartë shkencor, gjithmonë në ndryshim.

Fakulteti ofron:

- Promovimin e kërkimit dhe të studimeve të avancuara në fusha të ndryshme teorike, praktike dhe aplikative në biologji-kimi, matematikë, informatikë, fizikë dhe në shkencat mjekësore.
- Promovimin e filozofisë të të mësuarit të studentëve për përgatitjen e tyre për profesione specifike.
- Organizimin e stafit akademik në grupe studimi dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta duke rritur mundësinë e kualifikimit të specializuar të stafit si dhe të bashkëpunimit mes tyre për realizimin e projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Krijimin e lidhjeve të qëndrueshme me departamente të ngjashme të shteteve të tjera me qëllim nxitjen e bashkëpunimit në drejtimin mësimor e kërkimor.
- Të sigurojë në shumicën e lëndëve projekte grupi dhe projekte individuale që simulojnë situata që do të hasin studentët në ambientet e punës në të ardhmen.
- Përgatitjen e trajnimit të mësuesave të: biologjisë, kimisë, matematikës, fizikës dhe të informatikës në arsimin parauniversitar, si dhe aftësimin e tyre për t’iu përgjigjur sfidave të zhvillimit të teknologjisë së informacionit.
- Të nxisë të mësuarit gjatë gjithë jetës duke inkurajuar punën individuale përtej njohurive që zhvillohen në auditorët e shkollës.

- Konsolidimin e mjaft arritjeve të punës shkencore në fushat e studimit të departamenteve, si dhe zgjerimin e mëtejshëm të tyre, sidomos në fushat mjedisore dhe mjekësore.
- Kualifikimin e punonjësve mësimorë dhe stafit ndihmës pedagogjik, si dhe përmirësimin e teknikave të mësimdhënies me anë të përdorimit të pajisjeve dhe teknikave audiovizive bashkëkohore.
- Nxitjen e të mësuarit aktiv dhe në mënyrë të pavarur, duke i dhënë përparësi realizimit të punëve laboratorike, praktikave në terren, projekteve të ndryshme, detyrave të kursit dhe sidomos punimeve të diplomave.
- Studentët e diplomuar në programet e studimit të FSHN-së të jenë të aftë të demonstrojnë kompetenca teorike, teknike dhe praktike në shkencat e natyrës dhe mjekësore.

Tab.3: Skeda informuese për FSHN-në

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti i Shkencave të Natyrës
Adresa:	Rruga Jeronim de Rada 12, Shkodër
Kontakt:	Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Licensuar:	2 Shtator 1957 si ILP Në vitin 1991, themelohet si fakultet më vete
Dekani	Prof. as. Dr. Rrok Smajlaj Email- rrok.smajlaj@unishk.edu.al
Departamentet	1. Departamenti i Matematikës 2. Departamenti i Fizikës 3. Departamenti i Biologji-Kimisë 4. Departamenti i Infermierisë
Ciklet e studimit	1. Cikli I i studimeve (7 programe studimi Bachelor) 2. Cikli II i studimeve (6 programe studimi Master Profesional dhe 1 program studimi Master Shkencor)

Tab.4: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHN-ja

Departamenti	Programi i studimit	Dokument Licensimi
1.Infermierisë	➤ Bachelor në Infermieri të përgjithshme (180 ECTS)	Shkresë MASH Nr. 784/1 prot., datë 05.06.2001
	➤ Bachelor në Mami (180 ECTS)	Shkresë MASH Nr. 3955 prot., datë 01.06.2007
	➤ Bachelor në Fizioterapi (180 ECTS)	Shkresë MASH Nr. 3954 prot., datë 01.06.2007
	➤ Master Profesional në Psikologji shëndeti (90 ECTS)	UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012
2.Biologji – Kimisë	➤ Bachelor në Biologji – Kimi (180 ECTS)	VKM Nr.150 prot., datë 18.04.1957
	➤ Master Shkencor në Biologji mjedisore (120 ECTS)	VKM Nr. 1162, datë 25.11.2009

	➤ Master Profesional në Mësuesi në Biologji – Kimi (120 ECTS)	VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008
3.Fizikës	➤ Bachelor në Fizikë (180 ECTS)	Vendim Nr 4/1 i Ministrit, datë 15.01.1999
	➤ Master Profesional në Mësuesi në Matematikë - Fizikë (120 ECTS)	VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008
4.Matematikës	➤ Bachelor në Matematikë (180 ECTS)	VMASH Nr. 4, datë 15.01.1999
	➤ Bachelor në Informatikë (180 ECTS)	Shkresë MASH Nr.2571/1 prot., datë 19.07.2002
	➤ Master Profesional në Mësuesi në Informatikë me Profil Minor në Matematikë (120 ECTS)	UMASH Nr. 506, datë 8.11.2010
	➤ Master Profesional në Mësuesi në Matematikë me Profil Minor në Informatikë (120 ECTS)	UMASH Nr. 506, datë 08.11.2010
	➤ Program studimi me karakter profesional Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike (120 ECTS)	VKM Nr. 190, datë 03.07.2020

❖ Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Fakulteti i Shkencave të Edukimit i ka fillimet e tij në vitin akademik 1981 – 1982, me hapjen e programit të studimit për Mësues për klasat I – IV të shkollës 9 – vjeçare (Cikli Ulët). Po në këtë vit akademik u krijua për herë të parë në Universitetin e Shkodrës, katedra e Psikologjisë dhe Pedagogjisë, e cila merret me problemet e degës së Mësuesisë për Ciklin e Ulët. Me shndërrimin e ILP-së në Universitet, me vendim të Ministrisë së Arsimit, nr. 125, datë 01.09.1991, u ngrit Fakulteti i Ciklit të Ulët për përgatitjen e mësuesve të klasave I-IV të shkollës 8-vjeçare dhe emërohet dekani i tij. Në vitin akademik 1996–1997, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 13.05.1996, pranë Fakultetit të Mësuesisë (Cikli Ulët) u hap dega “Mësues për Ciklin parashkollor”, për përgatitjen e edukatoreve të kopshteve. Me vendim të Senatit të USH-së, me nr. 117, datë 31.10.2000 bëhet ndërrimi i emrit nga Fakulteti i Ciklit të Ulët në Fakultet i Shkencave të Edukimit, emër të cilin e mban edhe sot.

Misioni. Fakulteti i Shkencave të Edukimit ka si mision formimin e studentëve me njohuritë më bashkëkohore për një përgatitje cilësore dhe konkurrentë si mësues për arsimin fillor, arsimin parashkollor dhe mësues të edukimit fizik. Synon të përgatisë specialistë të këshillimit psikologjik, të fushës së psikologjisë dhe punonjës socialë. Në fushën e artit synon të përgatisë specialistë në Pedagogjinë muzikore dhe në artet pamore, të aftë për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit e të vendit si dhe në kërkimin shkencor.

Politika e Cilësisë: Të mbajë dhe të zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigures i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioriteteve të zhvillimit të vendit.

Fakulteti ofron:

- Kurrikula të pasura dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, (Cikli I dhe Cikli II), në zbatim të Deklaratës së Bolonjës, legjislacionit për Arsimin e Lartë dhe

udhëzimeve të MASR, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë e nevojshme praktike.

- Staf akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore, profesionalizëm dhe përkushtim i tij për t'u përballuar me sfidat për përmbushjen e qëllimeve që ka FSHE-ja.
- Nivel të lartë të punës kërkimore-shkencore të pedagogëve dhe të aktivitetit të tyre botues.
- Monitorim i përvitshëm i cilësisë së mësimdhënies.
- Numër të lartë aktivitetesh të realizuara nga pedagogët me studentë (orët e hapura, të ftuar specialistë të fushës).
- Marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes lokale dhe shërbimet e ofruara nga OJF-të, ku zhvillohen praktikat profesionale të studentëve.

Tab.5: Skeda informuese për FSHE

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Adresa:	Rruga "Kolë Heqimi", Shkodër
Kontakt:	Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Licensuar:	VKM nr.125, datë 01.09.1991 si Fakultet i Ciklit të Ulët. Vendim Senati nr.117, datë 31.10.2000 si Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Dekani	Prof. as. Dr. Fatmir Vadohej Email- fatmir.vadahi@unishk.edu.al
Departamentet	1. Departamenti Psikologji-Punë Sociale 2. Departamenti i Mësuesisë 3. Departamenti Edukim fizik dhe sporte 4. Departamenti i Arteve
Ciklet e studimit	1. Cikli I i studimeve (7 programe studimi Bachelor) 2. Cikli II i studimeve (3 programe studimi Master Profesional dhe 3 programe studimi Master Shkencor)

Tab.6: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHE-ja

Departamenti	Programi i studimit	Dokument Licensimi
1.Psikologji - Punë Sociale	➤ Bachelor në Psikologji (180 ECTS)	Shkresë MASH Nr. 4276 prot., datë 01.07.2004
	➤ Bachelor në Punë Sociale (180 ECTS)	VKM Nr.560, datë 12.08.2005
	➤ Master Shkencor në Psikologji klinike (120 ECTS)	UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011
	➤ Master Shkencor në Psikologji organizative (120 ECTS)	UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011

	➤ Master Profesional në Shërbimet sociale (Për vitin akademik 2021-2022)(60 ECTS)	VKM Nr. 334, datë 17.09.2021
2.Mësuesisë	➤ Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor (180 ECTS)	VKM Nr.167, datë 28.05.1991
	➤ Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor (180 ECTS)	VKM Nr.332, datë 13.05.1996
	➤ Master Shkencor në Mësuesi në Biologji-Kimi, me Profil Minor në Karriera dhe aftësimi për jetën (120 ECTS)	VKM Nr. 548, datë 16.08.2012
	➤ Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor (120 ECTS)	VKM Nr.598, datë 07.12.2012
3.Edukim Fizik dhe Sporte	➤ Bachelor në Edukim fizik dhe sporte (180 ECTS)	Shkresë e MASH-it Nr. 2742 prot., datë 27.04.2006
	➤ Master Profesional në Mësuesi në lëndët Edukim fizik dhe sporte (120 ECTS)	VKM Nr. 1212, datë 11.12.2009
4.Departamenti i Arteve	➤ Bachelor në Pikturë dhe Grafikë (180 ECTS)	UMASH Nr. 272, datë 20.07.2015
	➤ Bachelor në Pedagogji muzikore (180 ECTS)	UMASH Nr. 272, datë 20.07.2015

❖ Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i ka fillesat e tij që me hapjen e katedrës së gjuhëve të huaja pranë Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, që mbulonte mësimdhënien e gjuhës ruse dhe të asaj frënge. Me shndërrimin e Institutit të Lartë Pedagogjik në Universitet në vitin 1991, kësaj katedre iu shtua dega e Gjuhës Angleze në vitin 1994, tashmë në përbërje të Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Po pranë kësaj katedre, më 1996, hapet dega e Gjuhës Gjermane, bazuar mbi draftmarrëveshjen mes USH-së dhe Universitetit të Gracit. Në vitin 1998 filloi veprimtarinë e tij programi i studimit Gjuhë Italiane, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Ministrisë së Jashtme Italiane bazuar në marrëveshjen protokollare mes Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë dhe Ministrisë së Jashtme Italiane. Në këtë marrëveshje parashikohej prania e një lektori italian, i cili zhvillon aktivitetin e tij pranë Universitetit të Shkodrës. Me vendim të MASH, nr.28, dt. 20.01.2001, miratohet hapja e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Misioni: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka si mision formimin e studentëve të nivelit Bachelor me njohuritë më bashkëkohore, duke synuar përgatitjen e tyre si specialistë në fushën e gjuhësisë, të letërsisë, të përkthimit dhe të komunikimit ndërkulturor, aftësimin e studentëve për të kryer punë kërkimore edhe në rrafshet krahasimore mes gjuhës dhe kulturës së studiuar dhe asaj shqipe. Formimin e studentëve të nivelit Master Profesional me metodologjitë dhe teknikat më bashkëkohore dhe të njohura në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj.

Politika e Cilësisë: Të ruajë standardet dhe të zhvillojë më tej rolet dhe synimin e fakultetit si sigures i cilësisë në arsimimin e brezave në funksion të kërkesave për specialistë dhe përkthyes të gjuhëve të huaja.

Fakulteti ofron:

- Një kurrikul të pasur dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, Bachelor dhe Master profesional, të hartuara me mbështetjen e fortë dhe të qëndrueshme të universiteteve dhe institucioneve partnere evropiane në bashkërendim me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësi për të fituar njohuritë më të përditësuara në fushën akademike dhe aftësitë praktike.
- Një kurrikul në bashkërendim me kërkesat dhe parimet evropiane që mundëson lëvizshmërinë e studentëve në programe studimi jashtë vendi me mundësi ekuivalentimi.
- Formim, përkushtim, korrektësi dhe profesionalizëm të stafit akademik të specializuar në universitete perëndimore për të përballuar dhe përmbushur me sukses sfidat dhe detyrimet në përmbushje të misionit të fakultetit dhe për t’u formuar në vazhdimësi.
- Mbështetje nga profesorë dhe personalitete të ftuar, vendas dhe të huaj, nga universitetet partnere që pasurojnë programet e studimit pranë këtij fakulteti, duke bashkëndarë përvojat e tyre me stafet e FGJH-së, përmes leksioneve të hapura dhe konferencave që realizohen me nisma të përbashkëta.
- Ndërthurje të shkëlqyer të njohurive teorike me ato praktike, përmes materialeve autentike që u ofrohen studentëve të nivelit Bachelor dhe praktika që realizojnë studentët Master profesional.
- Bashkëpunime të frytshme me universitete evropiane, që ofrojnë mundësi të shkëlqyera studimi përmes akordimit të bursave për studentët dhe përvoja shkëmbimi dhe pasurimi profesional për stafin akademik.
- Ofrimi i bursave semestrale në kuadër të programit Erasmus+ në universitete gjermane dhe italiane.
- Mësimdhënie nga lektorë të huaj austriakë, italianë, amerikanë, të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së studimit akademik.
- Klimë pozitive bashkëpunimi mes stafit akademik dhe studentëve. Në fakultetin tonë mirëpritën studentët e trojeve dhe të huaj me kuota të veçanta.

Tab. 7: Skeda informuese për FGJH

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Adresa:	Rruga “Dom Bosko”, nr.2, Shkodër

Kontakt:	dekanatifgjhush@gmail.com Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Dekani	Prof. as.dr. Edlira Bushati Email- edlira.bushati@unishk.edu.al
Licensuar:	VKM Nr. 28, datë 20.01.2001 si Fakultet i Gjuhëve të Huaja
Akredituar:	Vendim i KA, Nr.130/4, datë 16.10.2006
Departamentet	1. Departamenti i Gjuhës Angleze 2. Departamenti i Romanistikës 3. Departamenti i Gjermanistikës
Ciklet e studimit	1. Cikli I i studimeve (4 programe studimi Bachelor) 2. Cikli II i studimeve (4 programe studimi Master Profesional)

Tab.8: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FGJH-ja

Departamenti	Programi i studimit	Dokument Licensimi
1. Departamenti i Anglistikës	➤ Bachelor në Gjuhë Angleze (180 ECTS)	VKM Nr. 300, datë 21.06.1994
	➤ Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Angleze (120 ECTS)	VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008
2. Departamenti i Gjermanistikës	➤ Bachelor në Gjuhë Gjermane (180 ECTS)	Shkresë MASH Nr. 960 prot. datë 11.03.1996
	➤ Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Gjermane (120 ECTS)	VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008
3. Departamenti i Romanistikës	➤ Bachelor në Gjuhë Frënge (180 ECTS)	VKM Nr.560, datë 12.08.2005
	➤ Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Frënge (120 ECTS)	VKM Nr. 1333, datë 01.10.2008
	➤ Bachelor në Gjuhë Italiane (180 ECTS)	VKM Nr. 146, datë 04.08.1998
	➤ Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Italiane (120 ECTS)	VKM Nr. 1333, datë 01.10.2008

❖ Fakulteti Ekonomik

Fakulteti Ekonomik është hapur në shtator të vitit 1993, me Vendim nr. 349, datë 10.8.1992 të MASH -it. Që nga viti 1993 deri në vitin 2000, Fakulteti ka pasur vetëm një degë, atë të Administrim - Biznesit. Ky departament e ka zanafillën si njësi mësimore në përbërjen e Fakultetit të Shkencave të Natyrës së këtij Universiteti. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.332, datë 13.05.1996 Fakulteti i Ekonomisë fitoi statusin e Fakultetit të pavarur brenda Universitetit të Shkodrës. Në vitin 2000, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës u miratua hapja e degës Financë-Kontabilitet dhe në 2001-in ajo e Marketing-Turizmit. Dega e Turizmit implementoi për herë të parë në Fakultetin Ekonomik sistemin sipas Deklaratës së Bolonjës që në vitin akademik 2005- 2006 me mbështetjen e Konferencës së Rektorëve Gjermanë. Në vitin akademik 2008 -2009 të tre degët e Fakultetit

Ekonomik kanë filluar procesin mësimor në Nivelin e Parë të Studimeve, sipas Deklaratës së Bolonjës, në sistemin 3 - vjeçar. Në vitin akademik 2009- 2010 në Fakultetin Ekonomik filloi për herë të parë cikli i dytë i studimeve me Masterin Shkencor në Turizëm të Qëndrueshëm dhe në vitin 2011 u hapën programet e Masterit Shkencor në specialitetet e Administrim-Biznesit, Financës dhe Kontabilitetit. Në vitin akademik 2012–2013 u hapën tre programe Masteri Profesional në Trashëgimi Kulturorë dhe Menaxhim Turizmi, Masteri Profesional në Administrim-Biznes dhe Masteri Profesional në Financë-Bankë. Ndërkohë në vitin akademik 2018-2019 u hap programi Master Profesional “Menaxhim financiar, kontabilitet dhe kontroll në administratën publike”, në kuadrin e projektit FINAC, i financuar dhe mbështetur nga fondet e Bashkimit Evropian.

Misioni: Fakulteti Ekonomik ka si mision formimin e studentëve me njohuri të më bashkëkohore duke synuar përgatitjen e tyre, si: menaxherë, financierë, kontabilistë dhe specialistë në fushën e turizmit të aftë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të komunitetit e të vendit, si dhe në kërkimin shkencor dedikuar fushës së ekonomisë.

Politika e Cilësisë: Të mbajë dhe të zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigures i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioritetëve të zhvillimit ekonomik të vendit.

Fakulteti ofron:

- Një kurrikulum të pasur dhe të larmishëm programesh mësimore në të dy ciklet e studimeve, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuri të fundit akademike dhe aftësitë praktike.
- Pjekuri e profesionalizëm, përkushtim i një personeli akademik dinamik për t'i përballuar me sukses sfidat në përmbushje të misionit të fakultetit.
- Mbështetje nga profesorë të ftuar vendas dhe të huaj, të cilët pasurojnë programet tona duke ndarë përvojat e tyre.
- Mundësi kombinimi të vazhdueshëm të njohurive teorike me praktikën profesionale në organizata biznesi, institucione të ndryshme, sipas fushës së studimit.
- Studime universitare që zhvillohen në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.
- Mundësi për të marrë pjesë në programet mësimore të ofruara nga Fakulteti Ekonomik edhe për studentët e trojeve shqiptare.
- Bashkëpunim i FE-së me universitete në Evropë dhe në SHBA për kërkimin shkencor, mobilitete për stafin akademik dhe studentët e këtij fakulteti.
- Bashkëpunim i vazhdueshëm i FE-së me komunitetin akademik, autoritetet e qeverisjes qendrore e vendore, komunitetin e biznesit dhe OJF-të në realizimin e misionit të tij.
- Fakulteti Ekonomik është i vendosur në zemër të rajonit verior të Shqipërisë, në qytetin e Shkodrës.

Tab.9: Skeda informuese për FE

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti Ekonomik
Adresa:	Sheshi "Dugajte e Reja", Shkodër
Kontakt:	Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Licensuar:	VKM nr.332, datë 1996
Dekani	Prof. as. Dr. Blerta Dragusha Email- blerta.dragusha@unishk.edu.al
Departamentet	1. Departamenti i Financë-Kontabilitetit 2. Departamenti i Administrim-Biznesit 3. Departamenti i Turizmit
Ciklet e studimit	1. Cikli I i studimeve (3 programe studimi Bachelor) 2. Cikli II i studimeve (4 programe studimi Master Profesional dhe 4 programe studimi Master Shkencor)

Tab.10: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FE

Departamenti	Programi i studimit	Dokument Licensimi
1.Financë Kontabilitetit	➤ Bachelor në Financë – Kontabilitet (180 ECTS)	Shkresë MASH Nr. 4390 Prot., datë 23.10.2000
	➤ Master Shkencor në Kontabilitet (120 ECTS)	UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011
	➤ Master Shkencor në Financë (120 ECTS)	UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011
	➤ Master Profesional në Financë – Bankë (120 ECTS)	UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012
	➤ Master Profesional në Menaxhimi financiar, kontabiliteti dhe kontrolli në administratën publike (60 ECTS)	UMASR Nr. 702, datë 19.10.2018
2.Administrim - Biznes	➤ Bachelor në Administrim – Biznes (180 ECTS)	VKM Nr. 349, datë 10.08.1992
	➤ Master Shkencor në Administrim - Biznes (120 ECTS)	UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011
	➤ Master Profesional në Administrim - Biznes (120 ECTS)	UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012
3.Turizëm	➤ Bachelor në Turizëm (180 ECTS)	MAS vendim 1803/1, datë 05.06.2001
	➤ Master Shkencor në Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm (120 ECTS)	VKM Nr. 1370, datë 10.10.2008
	➤ Master Profesional në Trashëgimi	UMASH Nr. 503, datë

❖ **Fakulteti i Drejtësisë**

Studimet e larta në Drejtësi në Universitetin e Shkodrës u hapën me VKM nr.349, datë 10.08.1992 “Për hapjen e degës së Drejtësisë dhe Administrim-Biznesit në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër”. Fakulteti i Drejtësisë u hap me VKM nr.332, datë 13.05.1996 dhe aktualisht ofron 4 programe studimi. Ai përbëhet nga 3 departamente: departamenti i të Drejtës publike, departamenti i të Drejtës civile dhe departamenti i të Drejtës ndërkombëtare dhe evropiane. Me VKM Nr. 191, datë 03.07.2020 është hapur Programi i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi me kohëzgjatje 5-vjeçare. Diplomat e lëshuara nga ky fakultet njihen prej vitesh në universitete të ndryshme, si p.sh., ato evropiane dhe amerikane.

Misioni: Fakulteti i Drejtësisë ka si mision t’u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme dhe specifike profesionale dhe shkencore në përshtatje me tregun e punës në fushën e të drejtës për:

- shkollën e magistraturës,
- nëpunës civilë gjyqësorë,
- administratën publike dhe administratën gjyqësore,
- profesionet e lira.

Ndër objektivat formuese është mundësia e aftësimin të studentëve për zbatimin dhe interpretimin e legjislacionit, për hartimin e akteve ligjore si juristë në administratën gjyqësore, publike e private, në aftësimin për argumentim të përshtatshëm për zgjidhjen e çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta të nevojshme për specialitetin përkatës në tregun e punës.

Politika e Cilësisë

Fakulteti i Drejtësisë synon rritjen e cilësisë së arsimit të studentëve nëpërmjet rritjes së cilësisë së mësimdhënies me metoda bashkëkohore dhe staf të kualifikuar në universitetet perëndimore.

Fakulteti ofron:

- Një kurrikulum të pasur dhe të larmishëm programesh mësimore në të dy ciklet e studimeve, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë praktike për hartimin e akteve ligjore si juristë në administratën gjyqësore, publike e private, në aftësimin për argumentim të përshtatshëm për zgjidhjen e çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta të nevojshme për specialitetin përkatës në tregun e punës.
- Një kurrikul në bashkërendim me kërkesat dhe parimet evropiane që mundëson lëvizshmërinë e studentëve në programe studimi jashtë vendi me mundësi ekuivalentimi.

- Infrastrukturë mbështetëse për studentët, mjedise me hapësira të përshtatshme dhe teknologji bazë, pajisje dhe programe kompjuterike, internet, bibliotekë universitare etj.
- Bashkëpunim të ngushtë student-pedagog dhe mbështetje të vazhdueshme për formimin profesional të studentëve.

Tab.11: Skeda informuese për Fakultetin e Drejtësisë

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti i Drejtësisë
Adresa:	Rruga “Jeronim de Rada” 12, Shkodër
Kontakt:	Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Licensuar:	VKM nr.332, datë 13.05.1996
Dekani	Dr. Gasper Kokaj Email- gasper.kokaj@unishk.edu.al
Departamentet	1. Departamenti i të Drejtës ndërkombëtare dhe Evropiane 2. Departamenti i të Drejtës publike 3. Departamenti i të Drejtës civile
Ciklet e studimit	1. Cikli I i studimeve (1 programe studimi Bachelor) 2. Cikli II i studimeve (3 programe studimi Master Shkencor)

Tab.12: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FD

Programi i studimit	Dokument Licensimi
➤ Program i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi (300 ECTS)	VKM Nr. 191, datë 03.07.2020
➤ Bachelor në Drejtësi (180 ECTS)	VKM Nr. 349, datë 10.08.1992
➤ Master Shkencor E Drejta kushtetuese dhe administrative (120 ECTS)	VKM Nr. 682, datë 25.08.2010
➤ Master Shkencor E Drejta private dhe e biznesit (120 ECTS)	VKM Nr. 1162, datë 25.11.2009

❖ Fakulteti i Shkencave Shoqërore

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është një prej themelvënësve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe e ka gjenezën e tij që në vitin 1957, vit kur u hap për herë të parë Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 28.05.1991, institucioni fitoi statusin e universitetit dhe brenda tij Fakulteti i Shkencave Shoqërore vijoi aktivitetin si njësi e veçantë me dy drejtime studimi: *Gjuhë - Letërsi dhe Histori - Gjeografi*. Që nga viti 1995 pranë këtij Fakulteti është ngritur dhe funksionon Qendra e Studimeve Albanologjike. Me UMASH Nr.498, datë 07.10.2011 në vitin akademik 2011-2012 u hap shkolla doktorale “*Gjuhë shqipe*”, e cila synon të kryejë studime komplekse

në fushë të gjuhësisë, si në rrafshin sinkronik, ashtu edhe në atë diakronik. Studimet albanologjike përbëjnë thelbin dhe veçantinë e të gjitha programeve të studimit të këtij fakulteti.

Misioni: Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka si mision formimin dhe kualifikimin e studentëve në të gjitha ciklet, përgatitjen e specialistëve në fushën e gjuhësisë, të letërsisë, të historisë, të gjeografisë, të gazetarisë, por edhe të disiplinave të përafërta kulturore, si: redaktorë gjuhësorë dhe letrarë, punonjës bibliotekë, ciceronë muzesh dhe guida turistike, zëdhënës shtypi e specialistë të sektorit të komunikimit. Gjithashtu ky fakultet përmes programeve të studimit Master Profesional në Mësuesi synon formimin e mësuesve të kualifikuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Përmes programeve të studimit Master Shkencor dhe Doktoraturë synohet formimi i specialistëve të profilit të lartë në fushat e sipërpërmendura, si: pedagogë, studiues e kërkues shkencorë.

Politika e Cilësisë: Fakulteti i Shkencave Shoqërore kujdeset dhe shquhet për cilësinë e studimeve në arsimin e lartë në të gjitha ciklet. Ai vepron në fushën e formimit kulturor dhe profesional, duke synuar arritjen e standardeve të larta dhe konkurruese në profilet e përmendura në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar, si dhe kujdeset për formimin dhe përditësimin e njohurive.

Fakulteti ofron:

- Programe studimi në të dy ciklet për të gjitha profilet e studimit, ndërsa për Gjuhën shqipe edhe në nivel doktorature.
- Kurrikula të larmishme dhe të përditësuara që u japin mundësi studentëve të përballen dhe të jenë të suksesshëm në tregun e punës.
- Staf akademik të kualifikuar brenda dhe jashtë vendit, me përvojë akademike, që ofron një mësimdhënie bashkëkohore.
- Personalitete me kontribute të veçanta nga fushat kërkimore që mbulojnë dhe bashkëpunim në kërkimin shkencor.
- Përfshirjen e të gjithë stafit të fakultetit jo vetëm në procesin mësimor, por edhe në kërkimin shkencor përmes botimeve me vlerë konkurruese në nivel kombëtar, në fushat përkatëse.
- Infrastrukturë mbështetëse për studentët, mjedise me hapësira të përshtatshme dhe teknologji bazë, pajisje dhe programe kompjuterike, internet, bibliotekë universitare etj.
- Bashkëpunim të ngushtë student-pedagog dhe mbështetje të vazhdueshme për formimin profesional e shkencor të studentëve.
- Lidhje të teorisë me praktikën përmes ekspeditave, praktikave profesionale, laboratorëve dhe punëve praktike.
- Mobilitet të studentëve në kuadrin e projekteve të ndryshme ndërkombëtare.
- Bashkëpunim me fakultetet simotra brenda dhe jashtë vendit, si dhe me qendra të rëndësishme kërkimore-shkencore.

Tab.13: Skeda informuese për FSHSH-në

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
Adresa:	Rruga “Jeronim de Rada” 4, Shkodër
Kontakt:	Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Licensuar:	VKM nr.167, datë 28.03.1991
Dekani	Prof. dr. Artan Haxhi Email- artan.haxhi@unishk.edu.al
Departamentet	1. Departamenti i Gjuhësisë 2. Departamenti i Letërsisë 3. Departamenti i Historisë 4. Departamenti i Gjeografisë
Ciklet e studimit	1. Cikli I i studimeve (4 programe studimi Bachelor) 2. Cikli II i studimeve (3 programe studimi Master Profesional dhe 3 programe studimi Master Shkencor) 3. Cikli i III i studimeve (Doktoraturë në “Gjuhë shqipe”)

Tab.14: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHSH

Departamenti	Programi i studimit	Dokument Licensimi
1.Gjuhësisë	➤ Bachelor në Gjuhë – Letërsi (180 ECTS)	VKM Nr.150 prot., datë 18.04.1957
	➤ Doktoraturë në “Gjuhë shqipe”	UMASH Nr.498, datë 07.10.2011
2.Letërsisë	➤ Bachelor në Gazetari dhe Komunikim (180 ECTS)	Shkresë MASH Nr. 2743 prot., datë 27.04.2006
	➤ Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë – Letërsi (120 ECTS)	VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008
	➤ Master Shkencor në Studime shqiptare dhe etnokulturore, profili “Studime të Thelluara në Gjuhësi” (120 ECTS)	VKM Nr. 619, datë 11.06.2009
	➤ Master Shkencor në Studime shqiptare dhe etnokulturore, profili “Etnokultura dhe Letërsia Shqipe” (120 ECTS)	VKM Nr. 619, datë 11.06.2009
3.Historisë	➤ Bachelor në Histori-Gjeografi me drejtim Histori (180 ECTS)	Shkresë MASH Nr. 1127 prot., datë 20.02.2006

	➤ Bachelor në Histori dhe trashëgimi kulturore (Për vitin akademik 2021-2022) (180 ECTS)	VKM Nr. 272, datë 21.07.2021
4.Gjeografisë	➤ Bachelor në Histori-Gjeografi me drejtim Gjeografi (180 ECTS)	Shkresë MASH Nr. 1127 prot., datë 20.02.2006
	➤ Master Shkencor Studime Regionale në Gjeografi (120 ECTS)	UMASH Nr. 212, datë 31.05.2013
	➤ Master Profesional në Mësuesi Histori – Gjeografi (120 ECTS)	VKM Nr.1212, datë 11.12.2009
	➤ Programi studimi me karakter profesional Udhërrëfyes turistik dhe Menaxhues i itinerareve turistike për Rajonin Verior (60 ECTS)	VKM Nr.196, datë 03.07.2020

2.3 Akreditimi i USH-së 2020

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit”, dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 24.01.2020, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, me vendim nr. 03, datë 24.01.2020 vendosi për Akreditimin Institucional të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër (Evidenca 1.1) me kohëzgjatje për 4(katër) vite deri më 23/01/2024 me 5 rekomandime për t’u përmbushur nga USH-ja.

Rekomandimet janë:

1. Institucioni, të sigurojë një rrjedhje më të mirë të informacionit nga nivelet e sipërme të menaxhimit tek ato të ulëta, dhe anasjelltas.

Në kuadër të këtij rekomandimi, USH-ja ka marrë masat e duhura për pajisjen me një e-mail zyrtar nga platforma Microsoft office 365 (@unishk.edu.al) të gjithë stafin administrativ, stafin akademik me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesshme si dhe hapjen e grupeve të ndryshme në këtë platformë, p.sh.: dekanet@unishk.edu.al, komisioniicilesise@unishk.edu.al etj. Në këtë mënyrë të gjithë mund të komunikojnë me

njëri-tjetrin për shpërndarjen e informacioneve dhe për një organizim më të mirë të veprimtarive të ndryshme.

2. Institucioni, të mundësojë autonominë financiare në nivelin e njërive bazë.

Në lidhje me përmbushjen e këtij rekomandimi mungojnë aktet nënligjore përkatëse për ta realizuar.

3. Institucioni, të sigurojë mbulimin e ngarkesës mësimore në programet e studimit të ciklit të parë nga staf akademik efektiv në masën të paktën 70%.

Për përmbushjen e këtij rekomandimi, gjatë vitit akademik 2020-2021 janë rekrutuar 17 pedagogë me kohë të plotë. Ndarja e pedagogëve sipas fakulteteve është:

-Tek Fakulteti i Shkencave të Natyrës janë rekrutuar 6 pedagogë me kohë të plotë (3 pedagogë tek Qendra e Studimit të Ujërave në Rajonin e Shkodrës, 2 pedagogë tek departamenti i Matematikës dhe 1 pedagog tek departamenti i Infermierisë);

-Tek Fakulteti i Shkencave të Edukimit janë rekrutuar 5 pedagogë me kohë të plotë (2 pedagogë tek departamenti i Psikologjisë dhe i Punëve Sociale, 2 pedagogë tek departamenti i Edukimit fizik e sporte dhe 1 pedagog te departamenti i Arteve);

-Tek Fakulteti i Drejtësisë janë rekrutuar 3 pedagogë me kohë të plotë;

-Tek Fakulteti i Shkencave Shoqërore janë rekrutuar 3 pedagogë tek departamenti i Historisë.

Aktualisht ky rekomandim plotësohet për programet e studimit të ciklit të parë që ofron USH-ja, me përjashtim të këtyre programeve: Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte (62.3%), Bachelor në Pedagogji muzikore (53%), Bachelor në Psikologji (69%), Bachelor në Infermieri të përgjithshme (51%), Bachelor në Fizioterapi (61%) dhe Bachelor në Mami (50%).

4. Institucioni, të gjejë mënyra më efektive për shpërndarjen e buxhetit për kërkim shkencor.

Tek buxheti i Universitetit është parashikuar fondi për kërkimin shkencor, por nuk ka një bazë ligjore të qartë për mënyrën e shpërndarjes së këtij fondi. Këtë vit me vendim Senati Nr.301, datë 04.10.2021 është vendosur që të shpërndahet shuma e parashikuar në buxhet të zëri për shpenzime për pjesëmarrjen në konferenca (kërkim shkencor) në mënyrë të barabartë për çdo njësi kryesore për vitin akademik 2020-2021 (**Evidenca 1.2**).

5. Institucioni, të riorganizojë ambientet ekzistuese të stafit akademik, në mënyrë që të rriten standardet teknike për hapësirat e punës dhe gjithashtu të sigurojë dritën natyrale.

Është bërë riorganizim i disa zyrave në ato fakultete ku ka pasur hapësira për të bërë lëvizje të tilla.

3.VETËVLERËSIMI

3.1 – FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMIN DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT

Autonomia

Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit. (Kreu III Standardi I.1)

Statuti i Universitetit të Shkodrës është hartuar në bazë të ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe i gjithë legjislacionit tjetër në fuqi për arsimin e lartë. Në Statutin e USH-së është përcaktuar qartë misioni i USH-së, autonomia, liria akademike, paprekshmëria, organizimi, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. Çdo ndryshim në Statut duhet të miratohet fillimisht nga Senati Akademik. Senati Akademik funksionon bazuar në rregulloren e tij (**Evidenca 1.3**). Statuti i USH-së është rifreskuar së fundmi me vendim Senati nr. Prot.725, nr.91, datë 02.03.2018 dhe është miratuar me urdhrin nr.366, datë 05.07.2018 të MASR ([Ref.link](#))(**Evidenca 1.4**). Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ka të miratuar me Vendim të Senatit nr. prot. 690, nr.116, datë 18.05.2010 "Rregulloren e brendshme të administratës së Universitetit" (**Evidenca 1.5**). Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë administrative të USH-së në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj. Njësitë përbërëse dhe organet e USH-së hartojnë rregulloret e tyre të brendshme në përputhje me LAL dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në statut, të cilat miratohen nga Senati Akademik. Fakultetet, departamentet dhe programet e studimit kanë rregulloret e tyre. Rregulloret e fakulteteve janë të miratuar me vendim të Senatit Akademik (**Evidenca 1.6**), ndërsa rregulloret e departamenteve dhe programeve të studimit, pasi miratohen në departamentet përkatëse kalojnë për miratim në Dekanat (**Evidenca 1.7**) (**Evidenca 1.8**).

Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë efikasitet në menaxhim. (Kreu III Standardi I.2)

USH-ja e ushtron aktivitetin duke u mbështetur në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në statutin e USH-së si dhe në aktet e tjera ligjore në fuqi. Në statut janë të specifikuar qartë organet kolegjiale të USH-së dhe detyrat e tyre. Organet kolegjiale të USH janë: a) Asambleja e personelit akademik; b) Senati Akademik; c) Komisionet e përhershme; d) Rektori; e) Dekanati; f) Bordi i Administrimit; g) Këshilli i Etikës. Organet me të larta vendimmarrëse janë Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Senati është organi më i lartë akademik i USH-së, përgjegjës për përmbushjen e misionit të USH-së si institucion i arsimit të lartë. Funkcionet e Senatit Akademik janë të përcaktuara qartë në nenin 17 të Statutit të USH-së. Ndërsa Bordi i Administrimit është organi më i lartë administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të USH-së, mbarëvajtjen financiare, administrative dhe të pronave të tij. Bordi i Administrimit funksionon bazuar në rregulloren e tij (**Evidenca 1.9**).

Në nenin 26 të statutit të USH-së janë të përcaktuara qartë funksionet e Rektorit si një organ

kolegjial i USH-së (Ref.[link](#)). Ndër detyrat kryesore që realizon është përgatitja dhe paraqitja e planit buxhetor vjetor dhe afatmesëm të USH-së para Senatit Akademik. Rektorati, gjithashtu, përcakton përbërjen e komisionit të ekspertëve që hartojnë politikat ekonomike e buxhetore të institucionit; formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore etj. **(Evidenca 1.10).**

Këshilli i Etikës i USH-së është organ kolegjial administrativ, i cili promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në procesin mësimor dhe atë kërkimore-shkencore dhe me veprimtaritë e tjera të USH-së. Trajton probleme që lidhen me etikën të parashikuara në Kodin e Etikës **(Evidenca 1.11).**

Organi më i lartë vendimmarrës në njësitë kryesore është Dekanati, i cili bën të mundur administrimin e procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, kryen funksionet akademike dhe administrative të parashikuara në Statutin e USH-së (neni 27) dhe në ushtrimin e kompetencave të tij shprehet me vendime **(Evidenca 1.12)**, të cilat merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve pjesëmarrës.

Institucioni favorizon debatin konstruktiv. *(Kreu III Standard 1.3)*

USH-ja është i organizuar në mënyrë të tillë që favorizon debatin konstruktiv në të gjitha nivelet. Departamenti është njësi themelore që mundëson dhe kryen diskutimin konstruktiv midis anëtarëve të stafit akademik. Mbasi vendimet merren në nivel departamenti kalojnë për diskutim dhe miratim në Dekanat **(Evidenca 1.13)**. Senati dhe organet e tjera kolegjiale mbledhen periodikisht sipas përcaktimeve në statutin e USH-së dhe materialet për diskutim përgatiten dhe vihen në dispozicion të anëtarëve të organeve kolegjiale të cilat bëhen objekt diskutimi përpara marrjes së vendimeve. Vendimet e marra nga organet kolegjiale janë të protokolluara dhe i kalohen strukturave përkatëse për zbatim, në përputhje me qëllimin e vendimit. Anëtarë të organeve kolegjiale janë edhe studentët të cilët kanë të drejtë të shprehin mendimet e tyre për çështjet që diskutohen.

Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij. *(Kreu III Standardi 1.4)*

Bazuar në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" USH-ja gëzon: autonomi organizative/administrative; autonomi financiare dhe autonomi në përzgjedhjen e personelit. Autonomia organizative dhe administrative e USH-së garantohet nëpërmjet të drejtës për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organet dhe autoritetet drejtuese, për të organizuar strukturat e brendshme përbërëse dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me LAL dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Autonomia financiare e USH-së garantohet nëpërmjet të drejtës për të përfituar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë; për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autonomia për përzgjedhjen e personelit të USH-së garantohet përmes të drejtës për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij si dhe për të përcaktuar pagat e personelit. Pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve, USH-ja ka instaluar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila monitoron

kufijtë e autonomisë akademike dhe administrative. Gjithashtu është krijuar Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit me vendim Senati nr.181, datë 31.05.2021, i cili përbëhet nga 9 anëtare (Ref.[link](#))(**Evidenca 1.14**). Ky Komision ka këto detyra: sigurimin e cilësisë në USH dhe në njësitë kryesore; të monitorojë dhe vlerësojë cilësinë e USH-së në bazë të udhëzuesit të ASCAL-it dhe Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë; të vlerësojë cilësinë e programeve të studimit që ofrojnë njësitë bazë; të hartojë dhe miratojë procedurat, kriteret dhe formatet e vlerësimit të cilësisë akademike në USH dhe në njësitë kryesore; të sigurojë ngritjen dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në USH dhe në njësitë kryesore. Gjithashtu janë krijuar NJSBC në nivel fakulteti dhe në nivel të programeve të studimit, të cilat kanë në përbërjen e tyre ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues nga studentët (**Evidenca 1.15**).

Institucioni harton një strategji zhvillimi. (Kreu III Standardi I.5)

Universiteti ka një Strategji Zhvillimi për vitet 2017-2021 e cila është e miratuar nga Senati Akademik. Strategjia e Zhvillimit përcakton aspektet kryesore të institucionit që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm, siç janë: mësimdhënia, kërkimi dhe inovacioni, komunikimi dhe informimi publik, tregu i punës, ndërkombëtarizimi, teknologjia e informacionit dhe komunikimit. Kjo strategji është hartuar tërësisht në përputhje me misionin dhe qëllimin e USH-së. Strategjia e zhvillimit 2017-2021 është publikuar në faqen e internetit të USH-së (Ref.[link](#))(**Evidenca 1.16**). Në kuadër të kësaj strategjie janë hartuar strategjitë sektoriale të USH-së, siç janë:

- Strategjia e studimit të tregut të punës
- Strategjia e mësimdhënies
- Strategjia e kërkimit dhe inovacionit
- Strategjia e komunikimit dhe e informimit publik
- Strategjia e ndërkombëtarizimit

Në përputhje me strategjinë e USH-së, janë hartuar edhe strategjitë e zhvillimit për disa programe studimi (**Evidenca 1.17**).

Institucioni publikon raportin vjetor, e paraqet atë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe para personelit akademik e studentëve. (Kreu III Standardi I.6)

Në mbështetje të nenit 32, të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", për çdo vit akademik institucionet e arsimit të lartë (IAL) duhet të paraqesin pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, raportet vjetore për veprimtarinë e kryer. Raportimi synon të ofrojë informacion për ministrinë mbi gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifatat e shkollimit për vitin në vijim, për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që ato ofrojnë, si dhe elementë të tjerë që lidhen me shërbimet që IAL-ja ofron. Departamentet hartojnë raportin mbi veprimtarinë mësimore-shkencore (**Evidenca 1.18**), ky raport i përcillet Dekanatit nga përgjegjësi i departamentit. Dekani dhe zv.dekani hartojnë raportin e punës shkencore për të gjithë fakultetin në bazë të raporteve të sjella nga departamentet dhe ky raport diskutohet në mbledhjen e Dekanatit (**Evidenca 1.19**). Pasi miratohet në Dekanat, raporti i përcillet Rektoratit i cili harton raportin përfundimtar dhe e paraqet para Senatit Akademik për diskutim. Pasi miratohet nga Senati Akademik i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Bazuar në gjetjet e raportit, Rektorati merr masa për përmirësimin e problemeve të përparimit të institucionit në përgjithësi ose në aspekte specifike, dhe gjithashtu përcakton strukturat përgjegjëse

për përmbushjen e tyre.

Krahas raporteve të punës kërkimore-shkencore, diskutohen dhe miratohen në mbledhjet e departamenteve dhe ato të dekanatit edhe RVB-të e fakulteteve dhe RVB-të e programeve të studimit, të cilat pasqyrojnë ecurinë dhe problematikat e tyre (Evidenca 1.20)(Evidenca 1.21).

Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë

Institucioni ngre struktura të përshtatshme për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij. (Kreu III Standardi II.1)

USH-ja e ushtron aktivitetin duke u mbështetur në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në statutin e USH-së. Për realizimin e misionit të vet dhe të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, USH-ja është i organizuar në 3(tre) njësi përbërëse:

1. Njësi kryesore/Fakultetet/Institutet kërkimore-shkencore
2. Njësi bazë/Departamentet/Qendrat kërkimore shkencore
3. Njësi ndihmëse akademike dhe administrative.

Fakulteti është njësi kryesore e USH-së që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura dhe ofron programe studimi të cikleve të ndryshme në përfundim të të cilave lëshon diplomën përkatëse. Departamenti është njësi bazë e USH-së, i cili nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Departamenti zgjedh drejtuesin e vet dhe funksionon duke u bazuar në rregulloren e vet të miratuar nga departamenti dhe të nënshkruar nga dekanët e fakulteteve përkatëse. Njësitë dhe mjediset ndihmëse në USH janë: a) njësitë administrative; b) labororet; c) biblioteka/t; d) palestra dhe mjediset sportive; e) njësitë teknike etj. Njësitë kryesore në USH janë: Fakulteti i Shkencave Shoqërore (4 departamente), Fakulteti i Shkencave të Edukimit (4 departamente), Fakulteti i Ekonomikut (3 departamente), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (4 departamente), Fakulteti i Drejtësisë (3 departamente), Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (3 departamente). Të dhënat për fakultetet, departamentet dhe programet e studimit gjenden edhe në faqen zyrtare të USH-së (Ref. [FSHN](#), [FSHE](#), [FE](#), [FSHSH](#), [FD](#), [FGJH](#)). USH-ja ka edhe 2 qendra kërkimore (Qendra e Studimeve Albanologjike pranë FSHSH dhe Qendra e Studimit të Ujërave pranë FSHN).

Organet drejtuese lehtësojnë vendimmarrjen nëpërmjet favorizimit të debatit në këshillat e institucionit. (Kreu III Standardi II.3)

Organet drejtuese lehtësojnë vendimmarrjen nëpërmjet favorizimit të debatit në këshillat e institucionit. Këshillat e USH-së siç janë Këshilli i Etikës, Dekanati, Komisionet dhe Asambleja e Stafit Akademik, luajnë një rol tepër të rëndësishëm në dhënien e mendimeve, propozimeve dhe marrjen e vendimeve në bazë të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në statutin e USH-së. Të gjitha propozimet, mendimet dhe vendimet që ndërmerren nga këshillat e lartpërmendura u përcillen autoriteteve drejtuese. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në të gjitha organet vendimmarrëse të USH-së, kështu ata kanë mundësi për të dhënë mendimet dhe propozimet e tyre për çështje të

ndryshme (Evidenca 1.22).

Partneriteti

Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij. (Kreu III Standardi III.1)

USH-ja i kushton një rëndësi të veçantë punësimit të të diplomuarve, duke i këshilluar dhe orientuar për mundësitë që ofron tregu i punës. Universiteti shërben si urë lidhëse e studentit me tregun e punës. Është miratuar me vendim Senati nr.71, datë 24.02.2017 Strategjia e Studimit të Tregut të Punës (Ref.[link](#))(Evidenca 1.23), ku janë përcaktuar objektivat e Universitetit siç janë: a) Përshtatja e kurrikulave me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës; b) Bashkëpunim i ngushtë me punëdhënësit për të njohur më mirë nevojat dhe tendencat e tregut të punës; c) Orientimi, këshillimi dhe zhvillimi i karrierës për studentët e tij që nga fillimi i studimeve në përputhje me nevojat dhe tendencat e tregut të punës. Në kuadër të akreditimit të programve të studimit (Evidenca 1.24), pjesa më e madhe e departamenteve kanë realizuar një studim të tregut të punës i cili i ndihmon ata të vendosin përparësi në programet e studimit bazuar në nevojat e rajonit (Evidenca 1.25). Departamentet zhvillojnë analiza të herëpashershme të tregut të punës për përshtatjen e kurrikulave, bashkëpunojnë ngusht me punëdhënësit për t'u njohur më mirë me nevojat dhe tendencat e tregut të punës. Për orientimin dhe monitorimin e punësimit të të diplomuarve është krijuar Zyra e këshillimit të karrierës dhe Alumnit në USH. Në faqen e internetit të USH-së është i publikuar pyetësori për ish- studentët (Ref. [link](#)), nëpërmjet të cilit mund të japin mendimin e tyre nëse janë punësuar, pasi kanë përfunduar studimet dhe nëse i ka ndihmuar apo jo programi i studimit që ata kanë ndjekur për t'u përgatitur për tregun e punës.

Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. (Kreu III Standardi III.2)

Një ndër prioritetet e Universitetit është ndërkombëtarizimi. Në këtë aspekt është hartuar edhe Strategjia e ndërkombëtarizimit 2017-2020 (Ref.[link](#))(Evidenca 1.26), e cila është pjesë përbërëse e strategjisë kryesore të këtij Universiteti. Në këtë drejtim USH-ja ka punur për nënshkrimin e marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit me universitetet vendase dhe të huaja, për realizimin e projekteve të përbashkëta si dhe për shkëmbime dhe bashkëpunime reciproke të profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit administrativ. Gjatë vitit akademik 2020-2021, USH-ja ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me Institucionet e tjera (Evidenca 1.27). Funkzioni koordinues me institucionet homologe të vendeve të huaja kryhet nga Zyra e Marrëdhënieve me jashtë.

Institucioni ndjek një strategji bashkëpunimi me institucionet e tjera mbështetëse. (Kreu III Standardi III.3)

USH-ja bashkëpunon me disa institucione të tjera për ofrimin e shërbimeve për studentët, në kuadrin e praktikave profesionale dhe për realizimin e projekteve të përbashkëta (me DAR Shkodër, DAR Lezhë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokurorinë e Rrethit Shkodër, Spitalin Rajonal të Shkodrës, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve Shkodër, Prefekturën Shkodër, Zyra e Punës Shkodër, OJQ, etj.), (Evidenca 1.28) si dhe në drejtimi të sigurimit të akomodimit të studentëve (me SHA "Student") etj.

Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të

studentëve në nivel ndërkombëtar. (Kreu III Standardi III.4)

Një ndër objektivat e Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të USH-së 2017-2020, është të zgjerojë, inkurajojë dhe mbështesë mobilitetin për studentët, stafin dhe kërkuesit, në të njëjtën linjë me strategjinë e Universitetit. Në kuadrin e bashkëpunimit me universitetet e tjera, pedagogët e USH-së kanë marrë pjesë në veprimtari të organizuara brenda dhe jashtë vendit (konferenca shkencore, kongrese, simpoziume, tryeza diskutimesh), sikundër edhe kanë mirëpritur kolegë të tyre nga universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit. USH-ja operon në kuadër të disa projekteve si Erasmus + (Tempus), Erasmus Mundus dhe CEEPUS. Prioritete të bashkëpunimeve kanë qenë shkëmbimet e eksperiencave të stafit me qëllim përmirësimin e cilësisë së kurrikulave dhe të mësimdhënies. Pedagogë nga FSHE-ja japin mësim pranë Universitetit të Malit të Zi, Fakulteti i Filozofisë, në programin studimor për Arsimimin e Mësuesve në Gjuhën Shqipe (**Evidenca 1.29**). Personeli akademik ftohet kryesisht në kuadrin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, në kuadrin e ligjëratave akademike për trajnimin e stafit akademik, në kuadrin e projekteve Erasmus + etj. Zyra e Marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve (Ref.[link](#)). Situata e krijuar nga pandemia e Covid 19 ka ndikuar në rënien e numrit të mobiliteteve, por pavarësisht kësaj, gjatë vitit akademik 2020-2021 ka pasur 13 mobilitete të studentëve, 4 mobilitete të stafit akademik për mësimdhënie dhe 1 mobilitet të stafit akademik për trajnim (**Evidenca 1.30**).

Përfundimi dhe Vlerësimi

USH-ja e ushtron aktivitetin duke u bazuar në LAL dhe Statutin, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njësitë përbërëse dhe organet e USH-së funksionojnë duke u bazuar në rregulloret e tyre të hartuara në përputhje me LAL dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në statut. Në statut janë të specifikuara qartë organet kolegjiale të USH-së dhe detyrat e tyre. Organet me të larta vendimmarrëse janë Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Senati dhe organet e tjera kolegjiale mbledhen periodikisht sipas përcaktimeve në statutin e USH-së. Vendimet e marra nga organet kolegjiale janë të protokolluara dhe i kalohen strukturave përkatëse për zbatim, në përputhje me qëllimin e vendimit.

Pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve, USH-ja ka instaluar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila monitoron kufijtë e autonomisë akademike dhe administrative. Gjithashtu është krijuar Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit me vendim Senati nr.181, datë 31.05.2021, i cili përbëhet nga 9 anëtarë. NJSBC e krijuara në nivel fakulteti dhe në nivel të programeve të studimit, kanë në përbërjen e tyre ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues nga studentët.

USH-ja paraqet çdo vit pranë MASR raportin vjetor për veprimtarinë e kryer në bazë të LAL. Për orientimin dhe monitorimin e punësimit të të diplomuarve është krijuar Zyra e këshillimit të karrierës dhe Alumnit në USH.

Një ndër prioritetet e Universitetit është ndërkombëtarizimi, në këtë drejtim USH-ja ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me universitetet vendase dhe të huaja, për realizimin e projekteve të përbashkëta, por edhe për shkëmbime dhe bashkëpunime reciproke të profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit administrativ në nivelin universitar dhe pasuniversitar. Zyra e Marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me

veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve. USH-ja bashkëpunon me disa institucione të tjera brenda vendit për ofrimin e shërbimeve për studentët, në kuadrin e praktikave profesionale dhe për realizimin e projekteve të përbashkëta.

Vlerësimi i fushës: **Standardet përmbushen plotësisht.**

3.2 – FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore. (Kreu III Standardi IV.1)

Në përputhje me ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kodin e Punës, Statutin e USH-së si dhe legjislacioneve të tjera në fuqi, USH-ja ka hartuar dhe miratuar rregulloren për "Zënie dhe ruajtjen e vendit të punës" (Ref.[link](#)) (Evidenca 2.1), në të cilën përcaktohen qartë rregullat dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. Aktualisht po punohet për rifreskimin e kësaj rregulloreje. Punësimi në USH realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Konkursi për vendet vakante shpallet nga Rektori, sipas propozimeve të njëjësive bazë ku gjendet një vend i tillë. Të gjitha njoftimet për vende vakante publikohen në faqen zyrtare të USH-së (<https://unishk.edu.al/njoftime-per-punesim>), si dhe tek Buletini i Njoftimeve Publike pranë Agjencisë së Prokurimit Publik. Njoftimi përmban pozicionin, përshkrimin e vendit të punës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, dokumentet që duhet të paraqesin kandidatët, afatin brenda të cilit duhet të kryhen aplikimet, vendin e dorëzimit të dokumentacionit dhe mënyrën e konkurrimit. Konkursi drejtohet nga një komision ad-hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse (Evidenca 2.2). Kandidatët fitues nënshkruajnë kontratën e punës me Rektoren, mbështetur në legjislacionin për Arsimin e Lartë dhe Kodin e Punës të RSH-së. Dokumentacioni dhe vendimet arkivohen dhe janë të disponueshme në Zyrën e burimeve njerëzore të USH-së dhe në Sekretarinë e dekanit të fakultetit.

Ka një bashkëveprim të mirë për koordinimin e punës mes dekanateve të fakulteteve të ndryshme. Në disa programe studimi zhvillojnë mësim kolegë nga fakultetet e tjera. Çdo fillim viti akademik, bazuar në nevojat e departamenteve, përgjegjësit hartojnë shkresat përkatëse dhe i dërgojnë tek Dekani, i cili dërgon shkresat për nevojat për pedagogë tek fakultetet përkatëse dhe në këtë mënyrë, studentit i sigurohet mësimdhënia e duhur, me specialistë të fushës (Evidenca 2.3).

Institucioni ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ. (Kreu III Standardi IV.2)

USH-ja ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ. Për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit

shkencor në Universitetin e Shkodrës është krijuar Zyra e Ekselencës. Kjo zyrë ka si qëllim kryesor të zhvillojë këto aktivitete:

-Trajnimin e pedagogeve të rinj mbi metodat e mësimdhënies dhe të pedagogëve me eksperiencë mbi të rejat në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

-Trajnimin e përfaqësuesve të institucioneve publike mbi metodat e reja menaxheriale dhe aftësitë komunikative.

-Trajnimin me tema të gjera ndaj komuniteteve të veçanta në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, arsimit dhe shkencës.

Zyra e Ekselencës ka rregulloren e saj në bazë të së cilës funksionon **(Evidenca 2.4)**.

Gjithashtu fakultetet organizojnë aktivitete trajnuese, konferenca, seminare apo ditë informimi për stafin akademik dhe personelin ndihmës mësimor-shkencor. Për të përmirësuar performancën akademike, FGJH ka organizuar trajnime të përbashkëta me institucione të tjera edhe në kushtet e zhvillimit të mësimi online siç është workshopi i organizuar nga departamenti i Gjuhës angleze me departamentin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Korçës **(Evidenca 2.5)**. Stafit akademik i departamentit të Gjuhës gjermane merr pjesë në webinarë, workshope me universitetet homologe brenda edhe jashtë vendit që organizohen nga DAAD (German Academic Exchange Service) dhe OeAD (Austria's Agency for Education and Internationalisation) **(Evidenca 2.6)**.

Për rritjen e kapaciteteve të stafit, USH-ja disponon Laboratorin e Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, i cili ofron trajnime të stafit akademik (Ref.[link](#), [link](#)). Ka një bashkëveprim të mirë mes stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme, mes departamenteve dhe fakulteteve si për realizimin e procesit mësimor, ashtu edhe për realizimin e veprimtarive të ndryshme, si p.sh., konferenca, aktivitete të ndryshme, etj. (Ref.[link](#)). Nga ana tjetër, edhe personeli administrativ, është gjithmonë i gatshëm për të asistuar pranë stafit për çdo problem teknik apo për ta pajisur stafin me guida ndihmëse, si p.sh., udhëzues për platformën Teams **(Evidenca 2.7)**.

Institucion ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij. *(Kreu III Standardi IV.3)*

Universiteti ka miratuar strategjinë sektoriale të mësimdhënies e cila është pjesë e rëndësishme e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” **(Evidenca 2.8)**. Synimi i kësaj strategjie është sigurimi i një mësimdhënieje cilësore dhe përfshirjeje më të madhe në drejtim të kërkimit shkencor nga ana e pedagogëve dhe studentëve si dhe rritje të konkurrencës së diplomave të USH-së në tregun e punës. USH-ja inkurajon trajnimet e personelit akademik në kualifikime të ndryshme: konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, trajnime brenda dhe jashtë vendit, mësimdhënien në universitetet perëndimore, duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat e mundshme, trajnimet nëpërmjet projekteve etj. Universiteti vlerëson aftësitë e personelit të tij përmes disa pikave si: a) marrja e feedback-ut lidhur me programin e studimit nga studentët nëpërmjet pyetësorve **(Evidenca 2.9)**; b) analizimi i raporteve të vetëvlerësimit të programeve të studimit në departamentet përkatëse, në dekanat dhe më pas i raportit përfundimtar në Senatin Akademik **(Evidenca 2.10)**; c) analiza e punës mësimore-shkencore në departamente, në dekanat dhe më pas i raportit vjetor në Senatin Akademik **(Evidenca 2.11)**; d) diskutimi dhe miratimi i sylabuseve të lëndëve në mbledhje të departamentit **(Evidenca 2.12)**, etj. Për pedagogët me kontratë 1-vjeçare përgjegjësi i departamentit harton një raport për

performancën e tij (**Evidenca 2.13**).

Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social. *(Kreu III Standardi IV.4)*

Studentët dhe pedagogët e USH-së, organizojnë veprimtari të ndryshme shoqërore të cilat dëshmojnë edhe në faqen e internetit të Universitetit (www.unishk.edu.al). Përmes veprimtarive të ndryshme sociale synohet të nxitet dhe të fuqizohet dialogu, mendimi i lirë dhe kreativiteti i studentëve. Puna vullnetare e studentëve dhe e stafit akademik synon të ndihmojë njerëzit në fusha të ndryshme. Studentët e FGJH-së janë ofruar vullnetarisht moralisht dhe financiarisht për të ndihmuar fëmijët jetimë për të përparuar në gjuhë të huaj dhe për të festuar festat e fundvitit (**Evidenca 2.14**). Po kështu, vlen të theksohet pjesëmarrja e studentëve të USH-së në veprimtari artistike dhe sportive, ku kanë fituar çmimet kryesore. Më 24-25 shtator 2020, në qytetin e Durrësit, u zhvilluan Finalet e Kampionatit të përvitshëm ndërmjet universiteteve, ku skuadra përfaqësuese e basketbollit për Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” u shpall fituese ([Ref.link](#)). Gjithashtu për herë të parë është organizuar Festivali i Filmit të Studentëve të Gazetarisë i mundësuar nga projekti USAID-it “Drejtesia për të gjithë” me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë, e Ambasadës Britanike dhe të ekspertëve të medias të Rana Labs nga Washingtoni. Studentët e Gazetarisë të USH-së u vlerësuan me vendin e parë me filmin “Rini e ikun” dhe me vendin e tretë me filmin “Historia e Fjonës” ([Ref.link](#)). Më datë 29.09.2020, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Sportit, në kuadrin e “*Javës Evropiane të Sportit*” organizoi garën demonstrative me biçikleta me studentët e departamentit të Edukimit fizik dhe sporteve ([Ref.link](#)). USH-ja organizon aktivitete të ndryshme me impakt social, si: panairët në fushën e turizmit, vizitat në shtëpinë e të moshuarve, aktivitetet e dhurimit të gjakut ([Ref.link](#)) etj.

Institucioni siguron menaxhimin efikas të burimeve njerëzore. *(Kreu III Standardi II.2)*

Organigrama e IAL-së është e qartë në organizimin e tij të brendshëm duke përfshirë të gjitha njësitë akademike dhe administrative të USH-së (**Evidenca 2.15**). Strukturimi i tyre është mbështetur në LAL dhe në Statutin e USH-së. Çdo njësi brenda Universitetit ka rregulloren e vet, ku përcaktohen qartë detyrat dhe qëllimet e çdo njësie apo të personelit, qoftë ai administrativ apo akademik. Sektori i burimeve njerëzore i USH-së kujdeset për dokumentacionin e të punësuarve, duke e azhurnuar dokumentacionin e tyre.

Menaxhimi Financiar

Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara. *(Kreu III Standardi VI.1)*

Njësitë akademike të USH-së nuk kanë autonomi financiare, buxheti është i centralizuar në nivelin e Universitetit. IAL financohet nga: buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për arsimim, të ardhurat për shërbimet e kryera, të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta, donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi, veprimtaritë kërkimore-shkencore. Struktura e hartimit të buxhetit të USH-së bëhet sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave, mbështetur në ligjin nr.80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë*” (i ndryshuar). Universiteti përfshin një strategji të përgjithshme buxhetore afatmesme për tre vjet. Në hartimin e buxhetit, Universiteti bazohet në

kërkesat e sjella nga fakultetet (**Evidenca 2.16**). Dekanatet i bazojnë kërkesat e tyre në nevojat e departamenteve, të cilat specifikohen në një mbledhje të veçantë (**Evidenca 2.17**). Shpenzimet e buxhetit të Universitetit bëhen transparente në nivelet e senatit, fakulteteve dhe departamenteve. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Bordin e Administrimit dhe në Senatin Akademik, kjo bën të mundur që informacioni mbi çështjet buxhetore, të mund të arrihet nga studentët.

Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare. (Kreu III Standardi VI.2)

Për të zbatuar politikën e vet financiare USH-ja mbështetet në grantin e buxhetit të shtetit dhe nga të ardhurat e siguruar nga shërbimet ndaj të tretëve, projektet, donacione dhe sponsorizime. IAL ka detyrim ligjor të kryejë një raport vjetor të kontrollit financiar. Ky raport kryhet nga njëسيا e auditimit të brendshëm, i cili identifikon problematikat në lidhje me menaxhimin e buxhetit dhe ofron rekomandimet respektive. Raporti u mundësohet të gjitha njësive (**Evidenca 2.18**). Drejtoria e financave pranë Rektoratit, ka përgjegjësi administrative për çështje financiare.

Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar. (Kreu III Standardi VI.3)

USH-ja si institucion i Arsimit të Lartë i nënshtrohet rregullave të ligjit nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 10296, dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, (i ndryshuar). USH-ja i nënshtrohet auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm, dhe rezultatet në të dy rastet i prezantohen organeve kolegjiale në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar).

Raporti i veprimtarisë financiare të USH-së miratohet në rektorat dhe pastaj nga dy organet kolegjiale, Senati dhe Bordi i Administrimit (**Evidenca 2.19**). Gjithashtu mendimi i studentëve merret edhe nga përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik dhe përfaqësuesi i tyre në Bordin e Administrimit. Raportet e KLSH-së, e auditit të MASH-it dhe e auditit të vetë institucionit, për IAL-të publike, janë shqyrtuar në Bordin e Administrimit në mbështetje të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar).

Menaxhimi i sistemeve të informacionit

Institucioni disponon një sistem të informimit. (Kreu III Standardi VII.1)

Portali UALBANIA është vetrina kryesore e universiteteve për të prezantuar ofertën e tyre akademike. Nëpërmjet portalit, maturantët njihen me kriteret, programet, aplikimin universitar dhe regjistrimin në programin ku janë shpallur fitues (Ref.[link](#)). Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), i cili i ofron Universitetit një hapësirë të dhënash për mësimdhënie, mësim, hulumtim, menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe administrative. Universiteti ka adoptuar disa aplikacione siç janë: SMAK, ESSE-3, LMS, Libraria Dixhitale dhe Biblioteka Universitare. Këto aplikacione gjenden tek faqja zyrtare e Universitetit (<https://unishk.edu.al>) dhe u vijnë në ndihmë studentëve, stafit akademik dhe administrativ të USH-së. Aplikacioni SMAK (<https://smak.unishk.edu.al/home>) është krijuar si rezultat i domosdoshmërisë për informatizimin e menaxhimit të planeve mësimore, ngarkesave të pedagogëve, evidencave mësimore dhe formularit financiar. Logimi dhe puna në soft mundësohet vetëm nëpërmjet një emri përdoruesi dhe fjalëkalimi. Përdoruesit janë të ndarë në

role të ndryshme (roli i pedagogut, përgjegjësit të departamentit, dekanit etj.) dhe secili rol ka të drejtë pune të përcaktuar (**Evidenca 2.20**). Programi ESSE-3 garanton një menaxhim efikas të të dhënave të studentit, ju vjen në ndihmë sekretarive mësimore dhe aktorëve të tjerë të universitetit, të specifikuara në rregulloren e këtij programi (**Evidenca 2.21**). Sistemi i Menaxhimit të Studimit (LMS) si mjedisi i studimit virtual, suportuar nga universiteti, është një mjedis web, i hartuar për të pajisur studentët dhe lektorët e tyre me një varg instrumentesh dhe burimesh për të lehtësuar studimin si për pedagogët ashtu dhe për studentët. LMS Moodle dhe Microsoft Teams, janë platforma modulare të cilat janë përdorur për mësimdhënien në distancë, dhe aksesohen nga i gjithë personeli akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentët. Në maj të vitit 2013 në bashkëpunim me bibliotekën lokale “Marin Barleti” u krijua faqja “Arkiva Dixhitale Shkodër”(BIBLIOTEKA SHKODER - DIGITAL) me perspektivën e zgjerimit të numrit të bibliotekave në Shkodër që mund të arkivojnë në këtë faqe vlerat e rralla që mbartin fondet e tyre (<http://adsh.unishk.edu.al/>). Këto shërbime vihen përherë në dispozicion të studentëve, të cilët kanë akses të lirë dhe falas për të konsultuar literaturën/bibliografinë e nevojshme apo materiale didaktike të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. Lista e paketave që përfshihen U-LIBRARY (<https://ualbania.al>), është e aksesueshme nga të gjithë studentët e të gjitha programeve të studimit.

Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit. (Kreu III Standardi VII.2)

USH-ja punon për informatizimin në çdo hap të punës student-sekretari mësimore-staf akademik-staf administrativ. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë në USH bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar përmes tyre oraret e mësimi, datat e provimeve, strukturën organizative, detyrimet e studentit, tarifat e studimit, vlerësimet e studentëve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së (www.unishk.edu.al). Gjatë vitit akademik 2020-2021, për shkak të Pandemisë Covid 19, Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë ka luajtur një rol kyç në menaxhimin e zhvillimit të mësimi online në USH, duke asistuar krejtësisht të gjithë procesin. IAL ka përpiluar strategjinë sektoriale të "Komunikimit dhe Informimit Publik" (Ref.[link](#))(**Evidenca 2.22**). Synimi i saj është të rregullojë dhe përmirësojë marrëdhëniet me publikun, përmes diversifikimit të mundësive për komunikim, shfrytëzimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit masiv bazuar jo vetëm në kërkesën për informim, por edhe në nevojën për të krijuar një nivel bashkëkohor dhe konkurrues të Universitetit në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Institucioni menaxhon pasuritë e paluajtshme. (Kreu III Standardi VII.3)

USH-ja menaxhon dhe mirëmban pasuritë e paluajtshme që ka në pronësi. Secili fakultet ka godinën e vet, të cilat kanë hapësira të organizuara për mësimdhënje, bibliotekë, laboratorë dhe administratë. Në mjediset e FSHE-së më 20 nëntor 2020, u hap Laboratori Informatik i financuar me fonde të Bashkimit Evropian në kuadër të projektit T@sk (**Evidenca 2.23**). Disa nga ndërtesat janë më të vjetra (të ndërtuara dekada më parë), ndërsa Godina e Re e Fakultetit Ekonomik është ndërtuar së fundmi, realizuar me fondet e FZHR (Fondi Shqiptar i Zhvillimit) dhe burimet e vetë USH-së. Bazuar në specifikat e programeve të studimit “Bachelor në Edukim fizik e sporte”, “Master profesional në Edukim fizik e sporte”, FSHE-ja disponon dhe palestrën (**Evidenca 2.24**). Brendësia e ambienteve mirëmbahet rregullisht dhe investohet rreth 1% e

vlerës së buxhetit për mirëmbajtjen e objekteve dhe hapësirave mësimore, kjo realizohet me burimet e vet USH-së dhe miratohet në buxhetet vjetore. Mbikëqyrja e projekteve të ndërtimit dhe rikonstruktimit bëhet nga dega e Investimeve dhe nga specialistë të jashtëm të licensuar.

Institucioni siguron ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore. *(Kreu III Standardi VII.4)*

USH-ja i kushton rëndësi të veçantë ruajtjes së vlerave akademike, kulturore dhe shkencore. Trashëgimia kulturore dhe shkencore ruhet e mirëmbahet në bibliotekën e Universitetit, bashkë me shumë shkrime, vepra dhe thesare të tjera kombëtare (<http://bush.unishk.edu.al/biblioteka/>). Godina aktuale e bibliotekës, një godinë bashkëkohore me tre kate dhe me sipërfaqe rreth 3000 m², është përfunduar në vitin 2006. Ajo është e pajisur me rafta librash që kanë një gjatësi 8 km linear dhe janë me një kapacitet mbajtës deri në 400 mijë libra. Biblioteka zotëron koleksione të pasura, si: fondin alban-balkanologjik, fondin shqip & të shkencave filologjike të albanologjisë, fondin e huaj, bibliotekën austriake, fondin e periodikut (të serialëve) dhe fondin e fakulteteve. Fondi i vjetër është në proces dixhitalizimi për të siguruar jetëgjatësinë e tij si dhe njëkohësisht për ta bërë atë sa më të disponueshëm për studiuesit e lexuesit. Biblioteka ka pësuar një ndryshim në organizimin e saj. Ajo operon sot me dy sektorë: 1. Sektori i klasifikatorë-restauratorëve; 2. Sektori i bibliotekarë-arkivistëve (**Evidenca 2.25**). Kjo risi organizimi ka dhënë impakt pozitiv në përmbushjen me sukses të detyrave nga stafi, sepse secili i përshtatet me kualifikimin përkatës për pozicionin që mban.

Institucioni ndjek një politikë të menaxhimit të aseteve të tij. *(Kreu III Standardi VII.5)*

USH-ja ka një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij; me salla leksionesh, seminaresh, biblioteka, laboratorë, sekretari, zyra për pedagogët etj. USH-ja bën përpjekje, në përputhje me mundësitë financiare për sigurimin e mjediseve në dispozicion të veprimtarisë së personelit akademik. USH-ja përpiqet të menaxhojë mirë asetet që ka në dispozicion, duke u kujdesur për mirëmbajtjen e tyre dhe për ristrukturimin e tyre në rast nevojë. Në përgjithësi, ambientet janë të pastra, me ngrohje, i kushtohet kujdes i madh pastrimit, ajrosjes dhe sidomos gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 i është kushtuar rëndësi e veçantë dezinfektimit të ambienteve. Ka ndërgjegjësim në rritje për përmirësimin e aksesibilitetit të studentëve me aftësi të kufizuara.

Institucioni ngrë një strukturë logjistike administrative për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët *(Kreu III Standardi VII.6)*

USH-ja ofron shërbime për palët e treta në përputhje me nevojat e tregut. Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Nr.1890 prot., datë 14.06.2021, ndërmjet Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër dhe LevizAlbania është themeluar dhe ushtron funksionet e veta Klinika e Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë (<https://unishk.edu.al/kerkimi-shkencor/projekte/klinika-e-ligjit>). Objektivi kryesor i Klinikës Ligjore është ofrimi i një kontributi në formën e ndihmës ligjore falas ndaj grupeve të shoqërisë apo individëve, të cilët nuk arrijnë t'i përdorin apo të përfitojnë nga të drejtat dhe liritë të parashikuara me ligj. Ekzistojnë laboratorë brenda njësisë akademike në të cilat ato ofrojnë shërbime për njësitë institucionale të jashtme, si dhe shërbime të drejtpërdrejta për popullatën, siç është laborator i mikrobiologjik dhe fizioterapia.

Menaxhimi i Veprimtarisë së Institucionit

Institucioni siguron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore. *(Kreu III Standardi V.1)*

USH-ja siguron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore. Godinat në dispozicion të USH-së të cilat janë të oragnizuara në salla leksionesh dhe seminaresh, ambiente për laboratorë, ambiente për biblioteka, ambiente për stafin akademik dhe administrativ, salla kompjuterash etj., ofrojnë një infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e veprimtarive akademike-shkencore. Falë materialeve me të cilat janë ndërtuar, ndërtesat e USH-së sigurojnë akustikë të mirë, izolim të mirë nga zhurmat dhe plotësojnë kërkesat teknike antisizmike. Universiteti siguron sistem ngrohjeje, internet wifi, pajisje kompjuterike dhe videoprojektorë për një zhvillim normal të mësimit në ambientet e tij. Ndërtimi i godinës së re të Fakultetit Ekonomik ka rritur ndjeshëm hapësirën në dispozicion të studentëve.

Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike. *(Kreu III Standardi V.2)*

Ruajtja e dokumentacionit në letër realizohet përmes sektorit të Protokollit, sektorit të Arkivës dhe Sekretarive mësimore të fakulteteve. USH-ja synon dixhitalizimin e të dhënave dhe ruajtjen e dokumentacionit në formë elektronike. Kjo punë realizohet nga Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë. Institucioni disponon të dhëna të përgjithshme për programin, formën, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve, të depozituara pranë njësive bazë dhe në Drejtorinë e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve. USH-ja disponon një regjistër bazë të studentëve me të dhëna, që ruhet pranë sekretarive mësimore të çdo fakulteti. Ky regjistër, në formë të shkruar dhe elektronike, pasqyron vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna për diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj.

Përfundimet dhe vlerësimi

USH-ja ndjek një politikë të qartë dhe të mirëstrukturuar për rekrutimin e pedagogëve në përputhje me rregulloren. Të gjitha njoftimet për vende vakante publikohen në faqen zyrtare të USH-së, si dhe tek Buletini i Njoftimeve Publike pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

Institucioni nxit integrimin e personelit të tij në shumë veprimtari akademike, kërkimore-shkencore dhe administrative, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Hapa pozitivë të mëtejshëm janë bërë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së pedagogut, përmes trajnimeve dhe mësimdhënies në vendet e Evropës Perëndimore. USH-ja evidenton dhe vlerëson arritjet e personelit të tij përmes analizave vjetore mësimore-shkencore, raporteve të vetëvlerësimit dhe marrjen e feedback-ut lidhur me programin e studimit nga studentët nëpërmjet pyetësorëve.

Studentët dhe pedagogët e USH-së, organizojnë veprimtari të ndryshme shoqërore të cilat dëshmojnë edhe në faqen e internetit të Universitetit. Përmes veprimtarive të ndryshme sociale synohet të nxitet dhe të fuqizohet dialogu, mendimi i lirë dhe kreativiteti i studentëve.

Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë në USH bashkërendon veprimtaritë në fushën e

teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar përmes tyre oraret e mësimit, datat e provimeve, strukturën organizative, detyrimet e studentit, tarifën e studimit, vlerësimet e studentëve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së. Trashëgimia kulturore dhe shkencore ruhet e mirëmbahet në bibliotekën e Universitetit, bashkë me shumë shkrime, vepra dhe thesare të tjera kombëtare.

USH-ja ka një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij; me salla leksionesh, seminaresh, biblioteka, laboratorë, sekretari, zyra për pedagogët etj. USH-ja përpiqet të menaxhojë mirë asetet që ka në dispozicion, duke u kujdesuar për mirëmbajtjen e tyre dhe për ristrukturimin e tyre në rast nevojë.

Vlerësimi i fushës: **Standardet përmbushen plotësisht.**

3.3 – FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA

Programet e Studimeve të ofruara

Institucioni ofron programe në përputhje me misionin dhe kushtet e infrastrukturës së tij.

(Kreu I Standard I.1)

USH-ja ofron programe studimi të tre cikleve të studimit: cikli i parë (Bachelor), cikli i dytë (Master i Shkencave dhe Master Profesional) dhe cikli i tretë (Doktoraturë në “Gjuhë shqipe”). Programet e studimit që ofron USH-ja janë të publikuara në faqen e internetit (<https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/>) si dhe në faqen zyrtare të ASCAL (<https://www.ascal.al/sq/lista-e-ial/programet-e-studimit>). Fakultetet organizojnë “Ditët e Hapura” në shkollat e mesme, me qëllim njohjen e maturanëve me programet e studimit që ofron USH-ja. Më datë 21 maj 2021 është zhvilluar në qytetin e Shkodrës nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë dhe MASR panairi "Work and Study", maturanët dhe studentët janë informuar për programet e studimit që ofrojnë IAL-të dhe mundësitë e punësimit që ofrojnë bizneset (Ref.[link](#)). Për orientimin dhe informimin e studentëve, në faqen zyrtare të USH-së është e publikuar guida për studentët e rinj (Ref. [link](#))(**Evidenca 3.1**). USH-ja bën vazhdimisht përpjekje për të hapur programe të reja studimi duke u bazuar në kërkesat e tregut të punës. Për vitin akademik 2020-2021 janë ofruar tre programe të reja studimi: Programi i studimit me karakter profesional Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike (VKM Nr. 190, datë 03.07.2020), Programi i studimit me karakter profesional Udhërrëfyes Turistik dhe Menaxhues i Itinerareve Turistike për Rajonin Verior (VKM Nr.196, datë 03.07.2020) dhe Programi i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi (VKM Nr. 191, datë 03.07.2020). Kushtet fizike dhe teknologjike të infrastrukturës që USH-ja disponon janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mundësuar zbatimin e programeve të studimit me efektivitet.

Me vendim Senati Akademik nr.182, datë 28.05.2019, është miratuar rregullorja e studimeve në USH (Ref.[link](#)) dhe vendimi nr.218/1, datë 22.01.2020, janë bërë disa ndryshime në këtë rregullore (**Evidenca 3.2**). Për politikat e pranimit të studentëve vendas dhe të huaj USH-ja

zbaton udhëzimet e dërguara nga MASR dhe Statutin e USH-së. Në faqen zyrtare të USH-së janë të publikuara vendimet e Senatit Akademik për kriteret e kandidatëve konkurrues për ndjekjen e studimeve dhe kuotat e pranimeve për të tre ciklet e studimeve që ofron USH-ja për vitin akademik 2020-2021 (Ref.[link](#))(Evidenca 3.3)(Evidenca 3.4).

Formimi i vazhdueshëm është pjesë integrale e programeve të studimeve. (Kreu I Standardi I.2)

USH-ja bën përpjekje për të realizuar formimin e vazhduar si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Me vendim Senati nr.103, datë 18.03.2015 është krijuar Qendra e Ekselencës me iniciativën e FE dhe FSHE dhe me vendim Senati nr.249, datë 17.07.2019 mori emertimin Zyra e Ekselencës, ku ndër të tjera, ka si funksion përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes trajnimeve të pedagogëve të rinj mbi metodat e mësimdhënies dhe të pedagogëve me eksperiencë mbi të rejat në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Gjithashtu Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në kuadër të Projektit “Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri” (TEAVET) (ERASMUS+), në periudhën maj 2019- maj 2020 ka realizuar disa module trajnimi me mësues të arsimit parauniversitar (Evidenca 3.5).

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. (Kreu I Standardi I.3)

Përmbajtja e programeve të studimeve është ndërtuar në përputhje me objektivat e strategjisë së zhvillimit të Universitetit 2017-2021 si dhe janë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e USH-së. Strategjia e mësimdhënies është pjesë e rëndësishme e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të Universitetit, ku synimi i saj është sigurimi i një mësimdhënieje cilësore dhe përfshirjeje më të madhe në drejtim të kërkimit shkencor nga ana e pedagogëve dhe studentëve si dhe rritje të konkurrencës së diplomave të USH-së në tregun e punës (Evidenca 2.8). Programet e studimit promovojnë vlerat dhe praktikat më të mira të arsimit të lartë në funksion të rritjes së cilësisë së jetës shoqërore dhe ekonomike në vend, duke përfshirë në përmbajtjen e tyre informacion të mjaftueshëm dhe koherent për studentët, të përditësuara me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore.

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë. (Kreu I Standardi I.4)

USH-ja ofron programe studimi që janë në përputhje me objektivat e përgjithshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Kurrikulat e programeve të studimit janë të hartuara duke u bazuar në Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe duke marrë parasysh kurrikulat e programeve të ngjashme të huaja, si dhe duke u përshtatur me kërkesat e zhvillimit social dhe ekonomik të vendit (Evidenca 3.6). Në këtë mënyrë, studentët tanë kanë mundësi studimi të mëtejshëm në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Fakulteti Ekonomik po bën përpjekje për hapjen e një doktorature në “Ekonomi dhe turizëm të qëndrueshëm” në kuadër të projektit MARDS. Tashmë aplikimi për këtë doktoraturë ka kaluar fazën e parë në MASR dhe është në proces në fazën e dytë të aplikimit.

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit. *(Kreu I Standardi 1.5)*

Programet e studimeve janë hapur me vendime respektive në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe janë në përputhje me kapacitetet e fakulteteve, si ato akademike, ashtu edhe kapacitetet infrastrukturore. Departamentet, çdo fillim viti akademik, diskutojnë dhe miratojnë ngarkesën mësimore vjetore të normuar dhe kohën vjetore të punës. Ngarkesa mësimore e pedagogut në IAL është ngarkesa e plotë vjetore prej 1536 orësh. Kjo ngarkesë pune për pedagogun përfshin mësimdhënien, kërkimin shkencor ose artistik, kontributin institucional dhe kontributin profesional të përshkruara në kontratën e punës e cila nënshkruhet çdo vit akademik nga punëdhënësi dhe punëmarrësi. Tashmë nëpërmjet sistemit SMAK ofrohet plotësimi i ngarkesave online nga stafi akademik, i cili më pas kalon për miratim tek drejtori i departamentit dhe dekani.

Programet e studimeve janë lehtësisht të kuptueshme dhe objektivat e tyre janë të përcaktuara qartë. *(Kreu I Standardi 1.6)*

Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë objektivat e tyre, të cilat janë në përputhje me objektivat e përgjithshme të institucionit. Informacioni që jepet në këto programe është i plotë, duke filluar që me emërtimin, kohëzgjatjen, pikëkreditet, vendimet e hapjes, objektivat formues, karakteristikat, strukturat akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, plani mësimor etj. Kurrikulat e programeve të studimit synojnë formimin e aftësive profesionale nëpërmjet ndërthurjes së teorisë me praktikën. Në rast transferimi të studimeve studentët pajisen me të gjitha të dhënat nga Drejtoria e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve. Kriteret e pranimit të studentëve janë të përcaktuara nga USH-ja dhe respektojnë bazën ligjore në fuqi (Evidence 3.3).

Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme. *(Kreu I Standardi 1.7)*

Programet e studimit të ciklit të parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme. Programet mundësojnë zhvillimin e aftësive krijuese, inovatore dhe sipërmarrëse të studentëve nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në funksion të përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies dhe lehtësimit të marrëdhënies pedagog-student. Studimet e nivelit të parë realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Njohuritë bazë që studenti fiton në programet e studimit të ciklit të parë në USH e lejojnë studentin të mbledhë kreditet (ECTS) e duhura për të aplikuar për studime të mëtejshme në nivelin Master. Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në programe të tjera homologe, bazuar në kreditet e fituara. Burimi i informacionit merret përmes rregullores përkatëse të studimeve (Evidenca 3.2). Sylabuset janë, gjithashtu, të bazuara në literatuara të huaja dhe të viteve të fundit (Evidenca 3.7).

Programet e studimeve të ciklit të parë hartohen në mënyrë të tillë që të lehtësohet ambientimi i studentit me mjedisin universitar. *(Kreu I Standardi 1.8)*

Stafi akademik angazhohet në realizimin e ditëve të informimit të maturantëve lidhur me programet e studimit të ofruara nga USH-ja, me organizimin, kreditet, kohëzgjatjen e programit

të studimit dhe organizimin në semestra. Gjithashtu ekzistojnë udhëzues të përgatitur (Evidenca 3.1) të cilët janë të dobishëm për studentët në orientim, por edhe faqja zyrtare e Universitetit ofron informacion të mjaftueshëm për orientimin e studentëve (<https://unishk.edu.al/>). Në ambientet e fakulteteve ka kënde të posaçme (në korridore të fakultetit) që bëjnë të njohur, krahas njoftimeve të tjera, edhe programet e studimeve dhe orarin mësimor. Fakultetet në përgjithësi kanë manuale për informimin e studentëve (Evidenca 3.8).

Programet e studimeve të ciklit të dytë mbështeten mbi kërkimin dhe për realizimin e tyre institucioni bashkëpunon me aktorë të fushës ekonomike. (Kreu I Standardi 1.9)

Programet e studimeve të ciklit të dytë (Master Shkencor dhe Master Profesional) mbështeten mbi kërkime dhe për realizimin e tyre, USH-ja ka bashkëpunuar me institucione të ndryshme. Objektivat e programit janë të përcaktuar qartë dhe përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit. Institucionet vendore publike dhe private me të cilat bashkëpunon USH-ja në kuadrin e realizimit të praktikave profesionale janë: Bashkia Shkodër, DAR Lezhe, Spitali Rajonal Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, OJF, Fototeka "Marubi", Institucione financiare bankare, zyra kontabiliteti dhe institucione të tjera të sektorit privat dhe shtetëror që operojnë në zonën e Veriut (Evidenca 1.28). Stafi akademik angazhohet në veprimtari kërkimore-shkencore, në hartimin e rregulloreve, RVB-ve dhe raporteve të ndryshme si dhe ka dhënë kontribut në drejtim të organizimit dhe pjesëmarrjes së gjerë në konferenca kombëtare e ndërkombëtare. Programet e studimit janë hartuar duke u mbështetur nga të dhënat mbi tregun e punës, të siguruar nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kryesisht Drejtorinë rajonale të arsimit Shkodër, Zyrën e Punës dhe Bashkinë lidhur me kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve Shqiptarë në Evropë dhe më gjerë. (Kreu I Standardi 1.10)

Programet e studimeve në USH synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe më gjerë. Kriteret që kanë lehtësuar mobilitetin e studentëve në Evropë dhe më gjerë janë: kurrikulat të cilat janë të organizuara në kredite (ECTS) sipas sistemit të Bolonjës; për të diplomuarit në të gjitha programet e studimit, diploma shoqërohet me suplementin/shtojcën e diplomës në shqip / anglisht; studentët që përfundojnë një program studimi të nivelit Bachelor zhvillojnë dy gjuhë të huaja, përkatësisht: në vitin e parë të studimeve zhvillojnë gjuhën angleze, në vitin e dytë të studimeve zhvillojnë njërin nga gjuhët e huaja: frëngjisht, italisht, gjermanisht, turqisht, në formën e lëndës me zgjedhje; Universiteti është pjesë e programeve Tempus, Erasmus + dhe ka shumë marrëveshje bilaterale midis institucioneve ndërkombëtare. Programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët apo institucionet me të cilat bashkëpunohet. Hartimi i programeve është realizuar edhe në bazë të konsultimeve me programe të ngjashme studimi kombëtare dhe ndërkombëtare, duke bërë të mundur lehtësimin e studentëve për të ndjekur në vazhdimësi studimet e mëtejshme edhe në universitete të tjera në

arenën ndërkombëtare (Evidenca 3.9).

Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike. (Kreu I Standardi I.11)

Programet e studimeve që ofron USH-ja mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike. Lëndët dhe modulet e programeve të studimit, në përgjithësi, realizohen nëpërmjet orëve të leksioneve të cilat i pajisin studentët me njohuri dhe aftësi teorike dhe seminareve të cilat mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive teorike. Në disiplina të veçanta janë të parashikuara orë laborator, projekte kursi, praktika dhe ekspedita në terren etj. (Evidenca 3.6). Bazuar tek Udhëzimi nr.15, datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”, dhe tek Vendim Nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, një nga tipat e veprimtarisë është “Përgatitje e tezës së diplomës”. Programet e studimit që ofron USH-ja e përmbajnë atë. Fakultetet, në përgjithësi, kanë përgatitur udhëzues për studentët për përgatitjen e punimeve të diplomave. Studentët e USH-së, gjithashtu, kanë marrë pjesë në mbështetjen e njësive bazë për organizimin e Konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara në këtë institucion. Departamentet vazhdimisht organizojnë dhe nxisin pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete jashtë kurrikulës.

Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim. (Kreu I Standardi I.12)

Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Programet e studimit të nivelit të dytë ofrojnë studime për studentët me kompetenca të përgjithshme dhe specifike profesionale që i sigurojnë një vendosje të mirë në tregun e punës. Programet e studimit përmbajnë praktika mësimore, të cilat kryhen në institucione dhe shoqata me të cilat USH-ja ka marrëdhënie bashkëpunimi. Praktikant profesional zhvillohen në vitin e fundit të secilit prej programeve të studimit nën mbikëqyrjen e pedagogëve përkatës të cilët janë nga stafi i brendshëm akademik dhe ekspertë të jashtëm.

Përfundimet dhe vlerësimi

USH-ja ofron programe studimi të tre cikleve të studimit: cikli i parë (Bachelor), cikli i dytë (Master i Shkencave dhe Master Profesional) dhe cikli i tretë (Doktoraturë në “Gjuhë Shqipe”). Po punohet, gjithashtu, për hapjen e një doktrature në “Turizëm të Qëndrueshëm” në kuadër të projektit MARDS. Faqia zyrtare e USH-së ofron informacion të detajuar për fakultetet, programet e studimit, kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve në USH, guida informuese për studentët e rinj etj.

USH-ja bën përpjekje për të realizuar formimin e vazhduar si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Për këtë arsye është krijuar Zyra e Ekselencës dhe Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, që kanë si funksion përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. USH-ja ofron programe studimi që janë në përputhje objektivat e përgjithshme kombëtare dhe ndërkombëtare, gjithashtu bën vazhdimisht përpjekje për të hapur programe të reja studimi duke u bazuar në

kërkesat e tregut të punës. Kurrikulat e programeve të studimit janë të hartuara duke u bazuar në LAL dhe duke marrë parasysh kurrikulat e programeve të ngjashme të huaja, si dhe duke u përshtatur me kërkesat e zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Kurrikulat e programeve të studimit synojnë formimin e aftësive profesionale nëpërmjet ndërthurjes së teorisë me praktikën. Programet e studimeve janë hapur me vendime respektive në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe janë në përputhje me kapacitetet e fakulteteve, si ato akademike, ashtu edhe kapacitetet infrastrukturore. Departamentet, çdo fillim viti akademik diskutojnë dhe miratojnë ngarkesën mësimore vjetore të normuar dhe kohën vjetore të punës. Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në programe të tjera homologe, bazuar në kreditet e fituara. Burimi i informacionit merret përmes rregullores përkatëse të studimeve.

Çdo vit akademik stafi angazhohet në realizimin e ditëve të informimit të maturantëve lidhur me programet e studimit të ofruara në USH, përmbajtjen e tyre, mundësitë e punësimit, etj. Universiteti, gjithashtu, ka përgatitur edhe Guidën orientuese, për informimin e studentëve të rinj. Informacioni i detajuar pasqyrohet edhe në faqen zyrtare të Universitetit.

Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar. Programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët apo institucionet me të cilat bashkëpunohet.

Programet e studimeve që ofron USH-ja mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike. Lëndët dhe modulet e programeve të studimit, në përgjithësi, realizohen nëpërmjet orëve të leksioneve të cilat i pajisin studentët me njohuri dhe aftësi teorike dhe seminareve të cilat mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive teorike. Në disiplina të veçanta janë të parashikuara orë laborator, projekte kursi, praktika dhe ekspedita në terren etj. USH-ja bashkëpunon me disa institucione vendore publike dhe private në kuadrin e realizimit të praktikave profesionale. Departamentet vazhdimisht organizojnë dhe nxisin pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete jashtë kurrikulës

Vlerësimi i fushës: Standardet përmbushen plotësisht

3.4- FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KËRKIMI

Organizimi i Programeve të Studimeve

Programet e studimeve të shpallura zbatohen në kushte të përshtatshme. *(Kreu I Standardi II.1)*

USH-ja ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit. Programet janë në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe janë objekt përmirësimesh të vazhdueshme (**Evidenca 3.9**). Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Vëmendje e veçantë i kushtohet realizimit të praktikave profesionale, në institucionet publike dhe private me të cilat USH-ja bashkëpunon. Në momentin që studentët vendosin se ku dëshirojnë të kryejnë praktikën profesionale, ata pajisen nga Fakulteti me një dokument, që i drejtohet institucionit ku do të zhvillohet praktika, duke u kërkuar atyre gatishmëri për pranimin e studentëve si praktikant. Gjithashtu në fund të praktikës, studentët pajisen nga institucioni me një dokument që vërteton angazhimin e tyre. Në fund të praktikës studentët vlerësohen me notë nga pedagogët në bazë të prezantimit final. Pedagogët, gjithashtu, bëjnë përpjekje për përmirësimin e sylabuseve, duke i përditësuar me literaturë bashkëkohore, si dhe duke përmirësuar metodat e mësimdhënies. Pedagogët orientojnë dhe ndihmojnë studentët në sigurimin e literaturës bazë dhe ndihmëse që është në gjuhë shqipe si dhe gjuhë të huaj. Institucioni ka tekste shkollore cilësore dhe literaturë plotësuese në sasi të mjaftueshme dhe ka një bibliotekë që ofron literaturë për studentët (<http://bush.unishk.edu.al/biblioteka/>). Në kuadrin e projektit T@sk, Biblioteka e Universitetit u pasurua me libra të fushës psiko-sociale (**Evidenca 4.1**). Studentët janë përgjithësisht të kënaqur me metodat e mësimdhënies, organizimin e kurrikulave dhe cilësinë e stafit mësimdhënës dhe sigurimin e literaturës mbështetëse. Këtë e dëshmojnë rezultatet e pyetësorëve, si shembull mund të përmenden rezultatet e pyetësorëve të zhvilluar në FSHE dhe në FGJH për të gjitha programet e studimit (**Evidenca 2.9**). Gjithashtu, Zyra e Sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të standardeve në muajin dhjetor 2020 ka zhvilluar Pyetësorin studentor “Vlerësimi i mësimdhënies online në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (**Evidenca A**) dhe në maj 2021 ka zhvilluar pyetësorin për sekretaritet mësimorë (Shtojca nr.1).

Institucionet e Arsimit të Lartë pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. *(Kreu I Standardi II.2)*

Studenti në përfundim të kursit të plotë të studimeve, për të fituar të gjitha kreditet e parashikuara në planin mësimor i nënshtrohet procesit të diplomimit për të fituar titullin sipas emërimit të diplomës. Diplomimi bëhet me provim përfundimtar ose me punim diplome, duke ndjekur të gjitha procedurat e hartuara nga institucioni dhe të parashikuara në Rregulloren e Studimeve (**Evidenca 3.2**). Udhëzuesi për provën finale ju vjen në ndihmë studentëve për hartimin e punimit të diplomës për ciklin e dytë të studimeve (**Evidence 4.2**). Në faqen zyrtare të Universitetit gjendet i gjithë informacioni në lidhje me oraret e provimeve, të riprovimeve, oraret e mësimi dhe provimit të diplomës (Ref.[link](#))(**Evidenca 4.3, 4.4, 4.5, 4.6**). Bazuar në nenin 30, pika 4 të Rregullores së Studimeve, pas vlerësimit me pikë të tezës së provimit, bëhet çsekretimi në prani

të komisionit, i cili i jep përgjigjen secilit prej studentëve dhe në rastin kur studentët nuk janë dakord me vlerësimin e bërë, në ditën e marrjes së rezultatit mund të bëjnë kërkesë me shkrim pranë Dekanit të fakultetit përkatës për rivlerësim. Kjo kërkesë i dërgohet departamentit përkatës, i cili krijon një komisionin *add-hoc* për rivlerësimin e studentit dhe njofton edhe pedagogun përkatës. Regjistrimi i studentëve për mbrojtjen e diplomës bëhet paraprakisht on-line. Nëpërmjet sistemit "Esse3" studentët në USH kanë akses në rezultatet personale të provimeve duke respektuar plotësisht parimin e konfidencialitetit (Ref.[link](#)). Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës (shqip dhe anglisht), të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin (**Evidenca 4.7**).

Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë. (*Kreu I Standardi II.3*)

Një nga objektivat kryesore të USH-së është përmirësimi i vazhdueshëm i programeve të studimit, me qëllim sigurimin e një formimi sa më bashkëkohor të studentëve, zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të përparura në fushën akademike dhe profesionale dhe përafrimin me tregun e punës dhe përmbushjen e këtyre nevojave. Secili departament e ka objektivat të vetin përmirësimin e secilit program studimi që mbulon.

Një objektivat të tillë departamentet e realizojnë përmes:

- diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve për programet e studimit në një mbledhje të veçantë në departament (**Evidenca 3.9**). Pedagogët sugjerojnë ndryshimet përkatëse në programin e studimit. Më pas shkresa kalon në Dekanat dhe më pas në Senat. Senati akademik, në një mbledhje të veçantë miraton ndryshimet e propozuara, nëse e gjykon të arsyeshme.

- marrjes në konsideratë edhe të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve. Realizohen pyetësorë me studentët të cilët japin vlerësimin e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies (**Evidenca 2.9**).

- organizimit çdo vit të mbledhjes "Analiza e punës mësimore dhe shkencore" (**Evidenca 1.19**). Gjatë këtyre mbledhjeve analizohet puna e bërë nga pedagogët për zbatimin e lëndëve sipas programeve të studimit dhe puna shkencore e secilit pedagog. Evidentohen arritjet, problematikat dhe vështirësitë të cilat bëhen objekt diskutimesh, me qëllim përmirësimin e tyre dhe përcaktohen objektivat për vitin pasardhës. Raportet kalojnë në Drejtorinë e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve për t'u përpiluar në një raport të vetëm, që më pas të miratohet nga Senati.

- për pedagogët e rinj të rekrutuar realizohen kontrole nga departamenti gjatë procesit mësimor, analizohet puna shkencore e pedagogut si dhe hartohet një raport nga departamenti për performancën e pedagogut (**Evidenca 2.13**).

- organizimit çdo vit të mbledhjes me tematikë "Miratimin e sylabuseve", ku secili pedagog pasqyron sylabuset e lëndëve dhe ndryshimet që ka bërë krahasuar me vitin akademik paraardhës, duke i argumentuar ato ndryshime që ka bërë (**Evidenca 2.12**).

- diskutimin dhe miratimin e RVB-ve për secilin program studimi dhe RVB-ve të fakulteteve. (**Evidenca 1.20, 1.21**).

- cilësia e programeve të studimeve vlerësohet edhe nga statistikat e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi. Institucioni monitoron punësimin e të diplomuarve të vet, nga njësia e departamentit në një periudhë 1-vjeçare nga mbarimi i studimeve.

Në fakultete janë krijuar dhe janë funksionale mekanizmat që monitorojnë cilësinë, siç janë NJSBC në nivel fakulteti dhe GVB-të e programeve të studimit (**Evidenca 1.15**).

Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. *(Kreu I Standardi II.4)*

Institucioni promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve që me aktivitetin e saj ndjek problematikat e parashikuara në “Rregulloren e brendshme të administratës” në USH. Politikat dhe procedurat në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, pasqyrohen në “Strategjinë e Mësimdhënies” e cila është pjesë e strategjisë kryesore të zhvillimit të USH-së. Staf i akademik i USH-së mbështetet në kualifikimet e tij në fushën e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies si brenda ashtu dhe jashtë shtetit duke synuar në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies nga ana pedagogëve me grada dhe tituj. Një rol shumë të rëndësishëm në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies luan Zyra e Ekselencës e cila realizon trajnime të vazhdueshme për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Gjithashtu me vendim të Senatit Akademik nr. 264, datë 15.07.2019, u krijua Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, pjesë e FSHE, që realizon trajnime për mësuesit parauniversitar (**Evidenca 3.5**).

Kërkimi: Rezultatet e kërkimit, përhapja, vlerësimi dhe transferimi i tyre.

Departamenti, si njësi bazë e institucionit, evidenton anët e tij të forta dhe dobësitë në fushën e kërkimit shkencor. *(Kreu II Standardi I.1)*

Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Departamentet inkurajojnë dhe promovojnë përpjekjet për kualifikimin e mëtejshëm shkencor të stafit, dhe kjo paraqitet në raportin vjetor për punën kërkimore-shkencore (**Evidenca 1.19**). Në raportet e punës kërkimore-shkencore, evidentohen arritjet dhe përcaktohen objektivat për vitin pasardhës. Buxheti parashikon fonde për kërkimin-shkencor (**Evidenca 4.8**), por nuk ka një bazë ligjore të qartë për mënyren e shpërndarjes së këtij fondi. Këtë vit me vendim Senati Nr.301, datë 04.10.2021 është vendosur që të shpërndahet shuma e parashikuar në buxhet të zëri për botime dhe pjesëmarrjen në konferenca në mënyrë të barabartë për çdo njësi kryesore për vitin akademik 2020-2021 (**Evidenca 1.2**). Shuma e shpërndarë do të përdoret nga pedagogët për pagesën e *fee-s* (tarifës) së konferencës dhe për botime.

Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor. *(Kreu II Standardi I.2)*

Institucioni inkurajon kërkimin shkencor në nivel fakulteti, kryesisht përmes promovimit të arritjeve të pedagogëve, bashkëpunimit për organizimin e konferencave, përmes bashkëpunimit me institucione të ndryshme apo përmes pjesëmarrjes në projekte të ndryshme. Bashkëpunimi me institucione të tjera kërkimore dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit, synon përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkim shkencor, projekte kërkimore etj. (**Evidenca 4.9, 4.10**) (Ref. [link](#)).

Institucioni përqendrohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit *(Kreu II Standardi I.3)*

Universiteti mbështet dhe promovon politikën e ndërkombëtarizimit të kërkimit. Vizioni dhe objektivat kërkimore shkencore janë paraqitur edhe në Strategjinë Sektoriale të Kërkimit dhe Inovacionit (**Evidenca 4.11**). Në qendër të vëmendjes së punës kërkimore të USH-së është zgjerimi dhe thellimi i veprimtarisë studimore përmes organizimit të veprimtarive shkencore,

pjesëmarrjes në projekte në bashkëpunim me institucione brenda dhe jashtë vendit. USH-ja është bërë pjesë e projektit IDEA që ka si qëllim përmirësimin e aksesibilitetit, krijimit të kushteve përfshirëse në edukim dhe zhvillimit të mundësive të punësimit për studentët me aftësi ndryshe dhe vështirësi në të nxënë në Ballkanin Perëndimor (Ref. [link](#)) (Evidenca 4.12). Institucioni është angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. Këtu, vlejné për t'u përmendur trajnimet e vazhdueshme që janë mbajtur në rang universiteti në kuadër të projektit TEAVET. Në kuadër të këtij projekti të mbështetur nga Erasmus + i Bashkimit Evropian është organizuar si aktivitet final i këtij projekti Konferenca Ndërkombëtare "Developing Teacher Competences for a Comprehensive VET System in Albania". Kjo konferencë është organizuar dhe realizuar nga Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" në mjediset e këtij universiteti, si edhe Kolegjit Universitar "Pavarësia" në datat 10 - 11 nëntor 2020, në Vlorë. U prezantuan mbi 100 referime shkencore si postera dhe prezantime. Nga universiteti ynë pati një pjesëmarrje tepër të kënaqshme me një numër të madh prezantimesh, mbi 20 të tilla (Ref.[Link](#)). Stafi akademik boton rregullisht artikuj, materiale shkencore në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Shumica e botimeve të stafit akademik gjenden në revisten "Buletini shkencor" i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (rivlerësuar si e tillë edhe me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Nr. 98, datë 28. 03. 2000, mbështetur në Vendimin Nr. 4, datë 17. 03. 2000, të Komisionit të Rikonsiderimit të Periodikëve Shkencorë) (Ref.[link](#)).

Institucioni përcakton fushat parësore të kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.4)

Përveç dy qendrave kërkimore, kërkimi shkencor në Universitet bazohet dhe në departamente, si njësi bazë që mbështetin programet e ciklit të dytë dhe të tretë. Senati akademik, me vendim Nr.97, datë 29.03.2021, miratoi fushat prioritare kërkimore në Universitetin e Shkodrës (Evidenca 4.13). USH-ja organizon vazhdimisht aktivitete që promovojnë debatin shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor nëpërmjet organizimit të leksioneve të hapura ose workshopeve të ndryshme. Aktivitetet e realizuara në frymën e këtij bashkëpunimi synojnë të përfshijnë sa më shumë kontributin e studentëve (Ref.[link](#)). Stafi akademik angazhohet dhe kontribuon në drejtimin dhe moderimin e tyre.

Institucioni zbaton prioritetet kërkimore shkencore. (Kreu II Standardi I.5)

Në bazë të kërkesave të tyre, fakultetet pajisen me bazën materiale të nevojshme, në funksion të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies (Evidenca 2.17). Prioriteti i USH-së është rekrutimi i personelit akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor në funksion të strategjisë për zhvillim të institucionit. USH-ja synon të rekrutojë në fushën e kërkimit shkencor, veçanërisht personat që kualifikimin e kanë kryer në universitete të huaja dhe mbështet stafin aktual në proces kualifikimi jashtë vendit.

Institucioni siguron vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.6)

Njesitë bazë dhe Qëndrat e Kërkimit përmes diskutimeve, veprimtarisë së tyre akademike dhe kërkimore orientojnë prioritetet e institucionit në fushën e kërkimit shkencor, duke pasur për bazë edhe Strategjinë e Kërkimit shkencor dhe Inovacionit. Institucioni ndjek një politikë integruese duke u dërguar ftesa kërkuesve të huaj kur vetë institucioni organizon konferenca shkencore apo leksione të hapura (Ref.[link](#)). Këto ftesa bëhen në kuadër të ndërkombëtarizimit të universitetit si dhe të bashkëndarjes së njohurive në fusha të caktuara. Shumë profesorë për periudha të shkurtra

studimi japin mësim dhe realizojnë kërkim shkencor në universitete të huaja. Kjo eksperiencë realizohet, pa çënuar procesin mësimor të tyre në USH (Evidenca 1.29).

Institucioni përpiket të integrojë kërkuesit shkencorë të huaj nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me studiues të huaj, si: në mësimdhënie, konferenca ndërkombëtare dhe evente të tjera të organizuara nga USH-ja.

Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.7)

Kërkimi shkencor pasqyrohet më së miri në monografitë dhe revistat periodike që boton çdo vit personeli akademik dhe veprimtaria shkencore pasqyrohet tek revista “Buletini Shkencor” (Ref.[link](#))(Evidenca 4.14). USH-ja ka organizuar konferenca ndërkombëtare dhe ka mundur publikimin e materialeve të këtyre konferencave. Institucioni informohet për veprimtarinë kërkimore shkencore të stafit të tij akademik përmes analizës së punës kërkimore-shkencore, që hartohet dhe diskutohet çdo vit, me qëllim mbështetjen e hulumtimit shkencor (Evidenca 1.19).

Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.8)

Vlerësimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor e realizojnë departamentet përmes analizës së kërkimit shkencor dhe diskutimeve në kontekstin e aktiviteteve të përqendruara në kërkime, përpilohen raporte si dhe planifikime për vitin e ardhshëm akademik. Institucioni mbron pronësinë intelektuale duke dhënë të drejta ekskluzive për studiuesit dhe promovon veprimtarinë kërkimore botuese (Ref. [Link](#)). USH-ja ndjek politikën e inkurajimit të përfshirjes së studiuesve të rinj në fushën e kërkimit shkencor. Gjithashtu aktivizon studentët e ciklit të dytë të studimeve me pjesëmarrje në konferenca shkencore (Ref.[link](#)).

Në kuadër të transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor USH-ja ka nënshkruar marrëveshje me institucione private dhe publike brenda vendit. Një pjesë e madhe e praktikave profesionale të studentëve realizohen pranë institucioneve të ndryshme që veprojnë në rajonin e Veriut të Shqipërisë, si: Dhoma e Tregtisë, DAR, banka të nivelit të dytë, kompani etj.

Përfundimet dhe Vlerësimi

USH-ja ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit. Programet janë në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe janë objekt përmirësimesh të vazhdueshme. Vëmendje e veçantë u kushtohet realizimit të praktikave profesionale, përmirësimit të sylabuseve, si dhe përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Institucioni ka tekste shkollore cilësore dhe literaturë plotësuese në sasi të mjaftueshme dhe ka një bibliotekë që ofron literaturë për studentët. Biblioteka e Universitetit është pasuruar së fundmi me libra në kuadrin e projektit T@sk. Pasi kanë kryer të gjitha detyrimet, studentët kanë të drejtën e diplomimit, provim me shkrim apo punim teme, bazuar në Rregulloren e studimeve. Pas marrjes së vlerësimit pozitiv, studentët pajisen me diplomën përkatëse, e shoqëruar me suplementin. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe ka informacion të hollësishëm rreth programit të studimit dhe vlerësimit të studentit.

Secili departament e ka objektivet e vetin përmirësimin e secilit program studimi që mbulon.

Një objektivi të tillë departamentet e realizojnë përmes:

-diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve për programet e studimit në një mbledhje të veçantë në

department;

-marrjes në konsideratë edhe të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve;

-organizimit çdo vit të mbledhjes "Analiza e punës mësimore dhe shkencore";

- për pedagogët e rinj të rekrutuar realizohen kontrole nga departamenti gjatë procesit mësimor, analizohet puna shkencore e pedagogut si dhe hartohet një raport nga departamenti për performancën e pedagogut;

-organizimit çdo vit të mbledhjes me tematikë "Miratimin e sylabuseve";

-diskutimit dhe miratimit të RVB-ve për secilin program studimi dhe RVB-ve të fakulteteve.

Në fakultete janë krijuar dhe janë funksionale mekanizmat që monitorojnë cilësinë, siç janë NJSBC në nivel fakulteti dhe GVB-të e programeve të studimit.

Departamentet inkurajojnë dhe promovojnë përpjekjet për kërkimin shkencor në nivel fakulteti, kryesisht përmes promovimit të arritjeve të pedagogëve, bashkëpunimit për organizimin e konferencave, përmes bashkëpunimit me institucione të ndryshme apo përmes pjesëmarrjes në projekte të ndryshme. Prioriteti i USH-së është rekrutimi i personelit akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor në funksion të strategjisë për zhvillim të institucionit. USH-ja synon të rekrutojë në fushën e kërkimit shkencor, veçanërisht personat që kualifikimin e kanë kryer në universitete të huaja dhe mbështet stafin aktual në proces kualifikimi jashtë vendit. Kërkimi shkencor pasqyrohet më së miri në monografitë dhe revistat periodike që boton çdo vit personeli akademik, këto veprimtari shkencore pasqyrohen tek revista "Buletini Shkencor".

Vlerësimi i fushës: **Standardet përmbushen kryesisht.**

3.5 – FUSHAT E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Studentët: Nga regjistrimi deri te punësimi

Institucioni ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve të rinj. (Kreu I Standardi III.1)

Pranimi në Universitet bëhet në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutin e USH-së dhe rregulloret e studimeve për secilin cikël studimi. Fillimisht kriteret e pranimi dhe numri i studentëve propozohen nga departamentet, miratohet në dekanat dhe pastaj kalon në Senat dhe miratohet nga Senati Akademik (Evidenca 3.4). Në programet e studimit të USH-së pranohen shtetasit shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë kushtet e përcaktuara nga MASR-ja. Pranimi në programin e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm. Në kuotat e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në USH për vitin akademik 2020-2021, përveç kuotave të kandidatëve brenda vendit, janë të parashikuara edhe kuotat e kandidatëve nga trojet (Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë), kandidatë të huaj, kuotat për personat me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, rom dhe ballkano-egjiptian. Në faqen zyrtare të USH-së publikohen datat e aplikimeve dhe të regjistrimit të studentëve (Ref.[link](#))(Evidenca 5.1).

Njësitë kryesore e ato bazë, si dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës bazuar në Statut dhe rregulloret ofron informacion për studentët e ardhshëm (maturantë), për politikën e pranimi të studentëve dhe për organizimin e programeve të studimit. Procesi i rekrutimit të studentëve të rinj fillon që me prezantimet e programeve të studimit që ofron USH-ja tek maturantët e shkollave të mesme të rajonit. Ky mision kryhet çdo vit nga grupet e stafit akademik të ngritura në fakultete, nëpërmjet takimeve të organizuara sipas një axhende paraprake, me maturantë të shkollave të mesme në kuadrin e "Ditëve të hapura". Prezantimet në media të aktiviteteve të organizuara janë gjithashtu pjesë e politikës promovuese ndaj maturantëve (Ref.[link](#)). Për secilin prej programeve të studimit pedagogët paraqesin edhe mundësitë që ofron tregu i punës në përputhje me formimin e studentëve të ardhshëm. Në këtë mënyrë nxënësit janë më të qartë paraprakisht për drejtimet që mund të ndjekin pasi përfundojnë studimet Bachelor. Faqja zyrtare e institucionit siguron informacion mbi kuotat dhe kriteret e pranimi, përfshirë studentët nga Shqipëria dhe nga jashtë. Po kështu, në faqen zyrtare publikohen listat e fituesve për secilin program studimi (Ref. [link](#)) (Ref.[link](#))(Ref.[link](#))(Evidenca 5.2, 5.3).

Institucioni ndjek një politikë të informimit të studentëve dhe siguron komunikimin ndërmjet tyre dhe personelit akademik. (Kreu I Standardi III.2)

Ka një larmi burimesh informimi për studentët. USH-ja realizon informimin e studentëve nëpërmjet faqes zyrtare të tij, në këtë faqe studentët mund të gjejnë informacion për programet e studimit që ofron USH-ja (Ref.[link](#)), kuotat e pranimi në universitet, si dhe përditësohet vazhdimisht me njoftime në lidhje me çdo aktivitet të institucionit (<https://unishk.edu.al/aktivitete>). Me qëllim informimin sa më cilësor të studentëve,

institucioni ka hartuar guidën përkatëse (Evidenca 3.1). Gjithashtu, pjesa më e madhe e fakulteteve dhe departamenteve kanë krijuar faqet e tyre në rrjete të ndryshme sociale si elementë të rëndësishëm të përcjelljes së informacionit (Evidenca 5.4). Fakultetet afishojnë në mënyrë të vazhdueshme postera informimi në ambientet e tyre ku pasqyrohen kurrikulat, oraret mësimore dhe njoftime të ndryshme, të cilat rifreskohen vazhdimisht.

Dekanati, sekretaria mësimore dhe sekretaria e dekanatit, si dhe njësitë bazë të fakultetit kanë orarin e pritjes së studentëve, me qëllim ofrimin e informacionit dhe sigurimin e mbështetjes së tyre për procesin mësimor apo problematika të tjera të lidhura me të (Ref. [link,link](#))(Evidenca 5.5). Në fakultete, secili departament bazuar në programet e studimit që mbulon, organizon shërbimin e tutoriatit për çdo grup studentësh (Evidenca 5.6). Pedagogu tutor ndjek nga afër studentët që ka nën kujdestari dhe është në shërbim të tyre për çdo paqartësi që ata kanë.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” që nga viti akademik 2013 ka adoptuar sistemin online të menaxhimit të studentëve “ESSE3” që kryen funksionin e mbështetjes online të tyre në procesin mësimor në formë elektronike (Ref.[link](#))(Evidenca 5.7). Secili pedagog, stafi administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë elektronike të brendshme të personalizuar (@unishk.edu.al), gjë që lehtëson komunikimin pedagog-student-staf administrativ. Në ndihmë të komunikimit sa më cilësor dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies janë edhe platformat LMS, Moodle dhe Teams në institucionin tonë (Evidenca 5.8), (Evidenca 2.7). Në USH ekziston një bazë e të dhënave studentore, e cila është e arkivuar në sekretarinë mësimore dhe përmban numrin e telefonit dhe adresën e e-mailit të secilit student. Sekretaria e studentëve është përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e dosjeve të studentëve.

Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve. (Kreu I Standardi III.3)

Struktura kryesore për orientimin dhe këshillimin e studentëve në USH është Zyra e këshillimit të Karrierës. Informimi dhe orientimi i studentëve arrihet edhe nëpërmjet teknologjisë informative. Në faqen web të Universitetit studentët mund të gjejnë informacione në lidhje me procesin mësimor, oraret e mësimit, provime, riprovime (Ref.[link](#)) (Evidenca 4.3, 4.4, 4.5), tarifatat vjetore të shkollimit (Ref.[link](#))(Evidenca 5.9), njoftime të llojeve të ndryshme që i përkasin aspektit mësimor, por edhe për mundësi të mobiliteteve si dhe aktivitetet ekstrakurrikulare. USH-ja nëpërmjet Sekretarisë mësimore dhe Zyrës së Kurrikulave orienton studentët të cilët dëshirojnë të transferojnë programet e studimeve. Procesi është i dokumentuar dhe arkivuar edhe për të gjitha prurjet e studentëve nga IAL të tjera apo anasjelltas.

Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta. (Kreu I Standardi III.4)

USH-ja respekton të drejtat e personave me aftësi ndryshe dhe i mbështet ata gjatë gjithë programit të studimit, duke krijuar sipas mundësive, kushte lehtësuese dhe ambiente të përshtatshme për to. Ndërtesa e re e FE-së është e pajisur me rampë në hyrjen e godinës dhe me ashensor, me qëllim lehtësimin e aksesueshmërisë për studentët me aftësi të kufizuara.

Universiteti ofron mbështetje financiare për grupe të veçanta studentësh, siç përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 39, datë 23.01.2019 (Ref.[link](#)). Në faqen zyrtare të universitetit shpallen datat e aplikimit dhe të regjistrimit për studentët që kanë mundësinë e përfitimit të lehtësirave financiare sikurse studentët me status të veçantë dhe aftësi të kufizuara (Ref.[link](#))(Evidenca 5.10). Tashmë USH-ja është pjesë e projektit IDEA, i cili synon përmirësimin e aksesibilitetit për studentët me aftësi të kufizuara dhe në këtë projekt marrin pjesë pedagogë nga FSHE, FSHN dhe FD (Evidenca 4.12). Fakulteti ofron mbështetje dhe lehtësira shtesë për studentët me aftësi ndryshe, si p.sh. studentët me dëmtime shikimi vlerësohen në provime me zë, në rastet kur programi i lëndës parashikon provim me shkrim në metodat e vlerësimit edhe për studentët paraplegjikë provimi zhvillohet në katin e parë në rast nevojë për këtë kategori.

Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët. (Kreu I Standardi III.5)

Secili pedagog ka të përcaktuar në sylabusin e lëndës literaturën bazë dhe ndihmëse dhe e evidenton në mbledhjen e departamentit ku miratohen sylabuset e lëndëve (Evidenca 3.7). Në përgjithësi, pedagogët vënë në dispozicion të studentëve tekste të autorëve të njohur në fushat përkatëse, leksione të shtypura, materiale ndihmëse të printuara, tekste të botuara nga pedagogët e tij dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera, tekste të përkthyer etj. Revista “Buletini Shkencor” që publikon artikujt dhe studimet shkencore të pedagogëve, shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët. Ai mund të gjendet në bibliotekën e Universitetit, ashtu sikurse edhe on-line në faqen zyrtare të universitetit, me akses të hapur për të gjithë (Ref.[link](#)). Nevojat e studentëve për literaturë mbështetëse ofrohet edhe nga Biblioteka e USH-së (<http://bush.unishk.edu.al/>). BUSH është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme. BUSH është e vendosur që në vitin 2006 në një godinë me tre kate dhe me një sipërfaqe 3000 m². Ajo ka një kapacitet mbajtës deri në 400,000 libra. 88% e fondit është hedhur në katalog elektronik dhe mund të aksesohet edhe nga jashtë bibliotekës, 51,520 tituj librash dhe 480 tituj periodiku. Biblioteka ka në fondet e saj rreth 112 100 ekzemplarë. Nga këto 70,560 ekzemplarë janë në gjuhë shqipe dhe 41440 janë në gjuhë të huaj. USH-ja parashikon në mënyrë periodike pasurimin dhe freskimin me tituj të rinj të literaturës për nevojat e institucionit, të parashikuara në zërat buxhetorë. Tashmë Biblioteka është pasuruar më tej me libra të fushës psiko-sociale në kuadrin e projektit T@ask (Evidenca 4.1). Mundësia për të pasur akses në literaturën më të fundit të disiplinave të ndryshme shkencore është rritur dukshëm pas krijimit të bibliotekës dixhitale nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Gjithashtu, në bashkëpunim me RASH, Drejtoria e IT-së e USH-së ka siguruar mundësinë e përdorimit të shërbimit të kësaj biblioteke dixhitale për të gjithë pedagogët dhe studentët e universitetit (Ref.[link](#)). Libra bashkëkohorë të literaturës ekonomike janë shtuar në bibliotekën e USH-së nga përkthimet e autorëve të njohur nga Fondi i Zhvillimit Shqiptaro - Amerikan (AADF). Në marrëveshjen e bashkëpunimit është siguruar edhe aksesimi i studentëve dhe stafit akademik në librarinë dixhitale të www.jstore.org si dhe korrigjimi elektronik “Clean Score” nëpërmjet skanimit të testeve dhe provimeve të lëndëve gjatë sezoneve semestrale.

Institucioni u ofron studentëve të ciklit të parë mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre. (Kreu I Standardi III.6)

Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Bachelor është 3 vite akademike. Numri total i krediteve që duhet të grumbullojë një student për finalizimin e këtij cikli studimi është 180 ECTS. Studentët e këtij programi studimi diplomohen me provim diplome ose tezë diplome. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma përkatëse (**Evidenca 5.11**). Secili departament bazuar në programet e studimit që mbulon, organizon shërbimin e tutoriatit për çdo grup studentësh (**Evidenca 5.6**). Departamenti aprovon listën e studentëve dhe emrin e tutorit. Pedagogu tutor ndjek nga afër studentët që ka nën kujdestari dhe është në shërbim të tyre për çdo paqartësi që ata kanë. Pedagogët organizojnë seanca konsultimi mbështetëse për studentët për lëndët që ata mbulojnë, në lidhje me vështirësitë që mund të kenë pasur gjatë procesit mësimor. Konsultimet kryhen rregullisht nga pedagogët sipas orareve që afishohen në departamentet përkatëse. Gjithashtu sekretaritetë mësimore kanë orare të caktuara pritjeje çdo ditë për nevoja apo sqarime të çështjeve administrative si regjistrime, data etj. Çdo student ka të drejtë të ketë një mbikëqyrës për të përgatitur tezën e tyre të diplomës. Studentët ndihmohen dhe udhëzohen që të gjejnë literaturë nga pedagogët për secilën lëndë.

Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale. *(Kreu I Standardi III.7)*

Institucioni garanton dhe krijon kushtet e përshtatshme dhe të sigurta, si dhe merr përsipër përfshirjen e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit, ku dhe shprehin mendimet dhe propozimet e tyre rreth kurrikulës, programeve të studimit dhe rregulloreve, buxhetit të USH-së etj. Gjithashtu, studentët kanë përfaqësues të tyre në NJSBC që krijohen në nivel njësie kryesore dhe në nivel të njëjësive bazë (**Evidence 1.15**). Në qershor të vitit 2018 u realizuan votimet për Këshillat Studentore të fakulteteve të USH-së dhe Këshillin Studentor Institucional të Universitetit të Shkodrës. Këto organizma krijojnë mundësinë që studentët të paraqesin në organet drejtuese të USH-së, mendimet dhe opinionet e tyre në lidhje me gjithë veprimtarinë akademike dhe shkencore në USH (Ref.[link](#))(**Evidenca 5.12**). Në nivel universiteti apo fakulteti, Këshillat Studentore kanë të drejtën t'u drejtohen me kërkesa organeve drejtuese të USH-së dhe fakulteteve, në të cilat ata shprehin kërkesat dhe mendimet e studentëve. Po kështu, këto organe janë të detyruara të shprehin ndaj kërkesave të paraqitura (Ref.[link](#),[link](#))(**Evidenca 5.13, 5.14**).

Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për të siguruar cilësinë e jetës studentore. *(Kreu I Standardi III.8)*

USH-ja ka pjesë të politikave të saj mbështetjen shumëdimensionale të studentit. Universiteti kontribuon në këtë drejtim përmes përfshirjes dhe mbështetjes së studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv. Në këtë mënyrë, përmes këtyre aktiviteteve USH-ja kontribuon në përmirësimin e jetës studentore dhe plotësimin e saj me aktivitete ekstrakurrikulare (Ref.[link](#), [link](#)). Angazhimi i studentëve në punë vullnetare dhe nisma bamirësie janë një praktikë e mirë e realizuar prej vitesh që është kthyer në traditë për USH-në (Ref.[link](#))(**Evidenca 2.14**). FGJH në bashkëpunim me organizatën jofitimprurëse "Eco Mendje", janë angazhuar sistematikisht në punë vullnetare dhe aktivitete bamirësie për të ndihmuar njerëzit në komunitet (**Evidenca 5.15**). FSHE, në

bashkëpunim me departamentin e Infermierisë së Fakultetit të Shkencave të Natyrës kontribuon përmes studentëve nëpërmjet dhurimit të gjakut për personat në nevojë (Ref.[link](#)). USH-ja ofron kushtet e duhura për të gjitha aktivitetet me karakter social dhe kulturor. Universiteti ka një departament të Edukimit fizik dhe sporteve që mbështet studentët për të organizuar aktivitete sportive.

Institucioni favorizon punësimin e studentëve. (Kreu I Standardi III.9)

Zyra e Këshillimit të Karrieres dhe Alumnit është struktura që mbledh dhe disponon të dhëna statistikore për punësimin e studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës në faqen e ALUMNIT ka hedhur tashmë formularin e regjistrimit të studentëve që kanë përmbyllur studimet në Universitetin e Shkodrës. Pasi formulari plotësohet, të gjitha të dhënat ruhen në databazën e USH-së. Në njërin nga pikat kërkohet punësimi aktual i të diplomuarit. Kjo pyetje është vënë me qëllimin që këto të dhëna të analizohen në të ardhmen dhe të eksplorohej përputhshmëria horizontale e programit dhe punësimin duke hedhur kështu hapat e parë drejt një studimi të hollësishëm të tregut të punës dhe procesit të gjurmimit të Aluminit (Ref.[link](#)). Panairi i Punës organizohet prej disa viteve radhazi në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, DRSHKP-në Shkodër dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë. Ai krijon mundësinë e ndërmjetësimit dhe takimit në mes punëdhënësve (Firmave të bizneseve të ndryshme) dhe punëkërkesve (studentëve) nëpërmjet vendosjes së kontakteve të drejtpërdrejta mes tyre. Në favor të punësimin të studentëve është edhe vet Universiteti si institucion, sepse shumë ish-studentë të USH-së janë tashmë pjesë e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitet. Gjithashtu zhvillimi i praktikave profesionale me Institucionet me të cilat bashkëpunon USH-ja kanë ndihmuar në punësimin e studentave, sepse disa studentë janë punësuar në këto institucione pas përfundimit të studimeve.

Përfundimet dhe Vlerësimi

Për pranimin e studentëve të rinj USH-ja ndjek një politikë të caktuar. Fillimisht kriteret e pranimit dhe numri i studentëve propozohet nga departamentet, miratohet në dekanat dhe pastaj kalon në Senat dhe miratohet nga Senati Akademik. Në programet e studimit të USH-së pranohen shtetasit shqiptarë dhe të huaj. Njësitë kryesore e ato bazë, si dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës bazuar në Statut dhe rregulloret ofron informacion për studentët e ardhshëm (maturantë), për politikën e pranimit të studentëve dhe për organizimin e programeve të studimit.

Ka një larmi burimesh informimi për studentët. USH-ja realizon informimin e studentëve nëpërmjet faqes zyrtare të tij, në këtë faqe studentët mund të gjejnë informacion për programet e studimit që ofron USH-ja, kuotat e pranimit në universitet, si dhe përditësohet vazhdimisht me njoftime në lidhje me çdo aktivitet të institucionit. Me qëllim informimin sa më cilësor të studentëve, institucioni ka hartuar guidën përkatëse. Fakultetet afishojnë në mënyrë të vazhdueshme postera informimi në ambientet e tyre ku pasqyrohen kurrikulat, oraret mësimore dhe njoftime të ndryshme, të cilat rifreskohen vazhdimisht. Dekanati, sekretaria mësimore dhe sekretaria e dekanatit, si dhe njësitë bazë të fakultetit kanë orarin e pritjes së studentëve, me qëllim ofrimin e informacionit dhe sigurimin e mbështetjes së tyre për procesin mësimor apo problematika të tjera të lidhura me të. USH-ja që nga viti akademik 2013 ka adoptuar sistemin online të menaxhimit të studentëve “ESSE3” që kryen

funksionin e mbështetjes online të tyre në procesin mësimor në formë elektronike. Secili pedagog, stafi administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë elektronike të brendshme të personalizuar (@unishk.edu.al), gjë që lehtëson komunikimin pedagog-student-staf administrativ. Në ndihmë të komunikimit sa më cilësor dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies janë edhe platformat LMS, Moodle dhe Teams në institucionin tonë.

USH-ja respekton të drejtat e personave me aftësi ndryshe dhe i mbështet ata gjatë gjithë programit të studimit, duke krijuar sipas mundësive, kushte lehtësuese dhe ambiente të përshtatshme për to. Tashmë USH është pjesë e projektit IDEA, i cili synon përmirësimin e aksesibilitetit për studentët me aftësi të kufizuara dhe në këtë projekt marrin pjesë pedagogë nga FSHE, FSHN dhe FD.

Secili pedagog ka të përcaktuar në sylabusin e lëndës literaturën bazë dhe ndihmëse dhe e evidenton në mbledhjen e departamentit ku miratohen sylabuset e lëndëve. Në përgjithësi, pedagogët vënë në dispozicion të studentëve tekste të autorëve të njohur në fushat përkatëse, leksione të shtypura, materiale ndihmëse të printuara, tekste të botuara nga pedagogët e tij dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera, tekste të përkthyer etj. Revista “Buletini shkencor” që publikon artikujt dhe studimet shkencore të pedagoqeve, shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët. Nevojat e studentëve për literaturë mbështetëse ofrohet edhe nga Biblioteka e USH-së, e pasuruar së fundmi me libra të fushës psiko-sociale në kuadrin e projektit T@ask.

Në përbërjen e NJSBC merr pjesë edhe një student. Gjithashtu, studentët kanë përfaqësues të tyre edhe në grupet e vlerësimit të brendshëm për programet e studimeve. Në qershor të vitit 2018 u realizuan votimet për Këshillat Studentore të fakulteteve të USH-së dhe Këshillin Studentor Institucional të Universitetit të Shkodrës. Këto organizma krijojnë mundësinë që studentët të paraqesin në organet drejtuese të USH-së mendimet dhe opinionet e tyre në lidhje me gjithë veprimtarinë akademike dhe shkencore në USH, i cili ka pjesë të politikave të tij mbështetjen shumëdimensionale të studentit. Universiteti kontribuon në këtë drejtim përmes përfshirjes dhe mbështetjes së studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv. Në këtë mënyrë, përmes këtyre aktiviteteve USH-ja kontribuon në përmirësimin e jetës studentore dhe plotësimin e saj me aktivitete ekstrakurrikulare. Angazhimi i studentëve në punë vullnetare dhe nisma bamirësie janë një praktikë e mirë e realizuar prej vitesh që është kthyer në traditë për USH-në, i cili hedh, gjithashtu, bazat e punësimit të studentëve pas diplomimit përmes bashkëpunimit me institucione të ndryshme të rajonit sikurse lidhjeve me DAR-in, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës dhe të tjerë aktorë, zhvillimit të praktikave, panairit të punës etj. Në favor të punësimit të studentëve është edhe USH-ja, sepse shumë ish-studentë të USH-së janë tashmë pjesë e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitet.

Vlerësimi i fushës: **Standardet përmbushen plotësisht.**

Përfundimet dhe vlerësimi i përgjithshëm

USH-ja e ushtron aktivitetin duke u bazuar në LAL dhe Statutin, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njësitë përbërëse dhe organet e USH-së funksionojnë duke u bazuar në rregulloret e tyre të hartuara në përputhje me LAL dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në statut. Në statut janë të specifikuara qartë organet kolegjiale të USH-së dhe detyrat e tyre. Organet me të larta vendimmarrëse janë Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Vendimet e marra nga organet kolegjiale janë të protokolluara dhe i kalohen strukturave përkatëse për zbatim, në përputhje me qëllimin e vendimit.

Pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve, USH-ja ka instaluar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila monitoron kufijtë e autonomisë akademike dhe administrative. Gjithashtu është krijuar Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit me vendim Senati nr.181, datë 31.05.2021, i cili përbëhet nga 9 anëtarë. NJSBC e krijuara në nivel fakulteti dhe në nivel të programeve të studimit, kanë në përbërjen e tyre ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues nga studentët.

Një ndër prioritetet e Universitetit është ndërkombëtarizimi, në këtë drejtim USH-ja ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me Universitetet vendase dhe të huaja, për realizimin e projekteve të përbashkëta, por edhe për shkëmbime dhe bashkëpunime reciproke të profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit administrativ në nivelin universitar dhe pasuniversitar. Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve. USH-ja bashkëpunon me disa institucione të tjera brenda vendit për ofrimin e shërbimeve për studentët, në kuadrin e praktikave profesionale dhe për realizimin e projekteve të përbashkëta.

USH-ja ndjek një politikë të qartë dhe të mirëstrukturuar për rekrutimin e pedagogëve në përputhje me rregulloren. Të gjitha njoftimet për vende vakante publikohen në faqen zyrtare të USH-së, si dhe tek Buletini i Njoftimeve Publike pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

Institucioni nxit integrimin e personelit të tij në shumë veprimtari akademike, kërkimore-shkencore dhe administrative, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. USH-ja evidenton dhe vlerëson arritjet e personelit të tij përmes analizave vjetore mësimore-shkencore, raporteve të vetëvlerësimit dhe marrjen e feedback-ut lidhur me programin e studimit nga studentët nëpërmjet pyetësorve. USH-ja ka një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij: me salla leksionesh, seminaresh, biblioteka, laboratorë, sekretari, zyra për pedagogët etj. USH-ja përpiqet të menaxhojë mirë asetet që ka në dispozicion, duke u kujdesuar për mirëmbajtjen e tyre dhe për ristrukturimin e tyre në rast nevojë.

Universiteti ofron programe studimi të tre cikleve të studimit: cikli i parë (Bachelor), cikli i dytë (Master i Shkencave dhe Master Profesional) dhe cikli i tretë (Doktoraturë në “Gjuhë Shqipe”). Po punohet, gjithashtu, për hapjen e një doktrature në “Turizëm të Qëndrueshëm” në kuadër të projektit MARDS. USH-ja ofron programe studimi që janë në përputhje objektivat e përgjithshme kombëtare dhe ndërkombëtare, gjithashtu bën vazhdimisht përpjekje për të hapur programe të reja studimi duke u bazuar në kërkesat e tregut të punës.

Kurrikulat e programeve të studimit janë të hartuara duke u bazuar në LAL dhe duke marrë parasysh kurrikulat e programeve të ngjashme të huaja, si dhe duke u përshtatur me kërkesat e zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Kurrikulat e programeve të studimit synojnë formimin e aftësive profesionale nëpërmjet ndërthurjes së teorisë me praktikën.

Programet e studimeve janë hapur me vendime respektive në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe janë në përputhje me kapacitetet e fakulteteve, si ato akademike, ashtu edhe kapacitetet infrastrukturore. Departamentet, çdo fillim viti akademik diskutojnë dhe miratojnë ngarkesën mësimore vjetore të normuar dhe kohën vjetore të punës. Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në programe të tjera homologe, bazuar në kreditet e fituara.

Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar. Programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët apo institucionet me të cilat bashkëpunohet.

Programet e studimeve që ofron USH-ja mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike. Lëndët dhe modulet e programeve të studimit, në përgjithësi, realizohen nëpërmjet orëve të leksioneve të cilat i pajisin studentët me njohuri dhe aftësi teorike dhe seminareve të cilat mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive teorike. Në disiplina të veçanta janë të parashikuara orë laborator, projekte kursi, praktika dhe ekspedita në terren etj. USH-ja bashkëpunon me disa institucione vendore publike dhe private në kuadrin e realizimit të praktikave profesionale.

Secili departament e ka objektiv të vetin përmirësimin e secilit program studimi që mbulon.

Një objektiv të tillë departamentet e realizojnë përmes:

-diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve për programet e studimit në një mbledhje të veçantë në departament;

-marrjes në konsideratë edhe të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve;

-organizimit çdo vit të mbledhjes "Analiza e punës mësimore dhe shkencore";

- për pedagogët e rinj të rekrutuar realizohen kontrole nga departamenti gjatë procesit mësimor, analizohet puna shkencore e pedagogut si dhe hartohet një raport nga departamenti për performancën e pedagogut;

-organizimit çdo vit të mbledhjes me tematikë "Miratimin e sylabuseve";

-diskutimin dhe miratimin e RVB-ve për secilin program studimi dhe RVB-ve të fakulteteve.

Për pranimin e studentëve të rinj USH-ja ndjek një politikë të caktuar. Fillimisht kriteret e pranimit dhe numri i studentëve propozohen nga departamentet, miratohen në dekanat dhe pastaj kalojnë në Senat dhe miratohen nga Senati Akademik. Në programet e studimit të

USH-së pranohen shtetasit shqiptarë dhe të huaj. Njësitë kryesore e ato bazë, si dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës bazuar në Statut dhe rregulloret ofron informacion për studentët e ardhshëm (maturantë), për politikën e pranimit të studentëve dhe për organizimin e programeve të studimit.

Ka një larmi burimesh informimi për studentët. USH-ja realizon informimin e studentëve nëpërmjet faqes zyrtare të tij, në këtë faqe studentët mund të gjejnë informacion për programet e studimit që ofron USH-ja, kuotat e pranimit në universitet, si dhe përditësohet vazhdimisht me njoftime në lidhje me çdo aktivitet të institucionit. Me qëllim informimin sa më cilësor të studentëve, institucioni ka hartuar guidën përkatëse. Fakultetet afishojnë në mënyrë të vazhdueshme postera informimi në ambientet e tyre ku pasqyrohen kurrikulat, oraret mësimore dhe njoftime të ndryshme, të cilat rifreskohen vazhdimisht. Dekanati, sekretaria mësimore dhe sekretaria e dekanatit, si dhe njësitë bazë të fakultetit kanë orarin e pritjes së studentëve, me qëllim ofrimin e informacionit dhe sigurimin e mbështetjes së tyre për procesin mësimor apo problematika të tjera të lidhura me të. USH-ja që nga viti akademik 2013 ka adoptuar sistemin online të menaxhimit të studentëve “ESSE3” që kryen funksionin e mbështetjes online të tyre në procesin mësimor në formë elektronike. Secili pedagog, stafi administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë elektronike të brendshme të personalizuar (@unishk.edu.al), gjë që lehtëson komunikimin pedagog-student-staf administrativ. Në ndihmë të komunikimit sa më cilësor dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies janë edhe platformat LMS, Moodle dhe Teams në institucionin tonë.

USH-ja respekton të drejtat e personave me aftësi ndryshe dhe i mbështet ata gjatë gjithë programit të studimit, duke krijuar sipas mundësive, kushte lehtësuese dhe ambiente të përshtatshme për to. Tashmë USH-ja është pjesë e projektit IDEA, i cili synon përmirësimin e aksesibilitetit për studentët me aftësi të kufizuara dhe në këtë projekt marrin pjesë pedagogë nga FSHE, FSHN dhe FD.

Secili pedagog ka të përcaktuar në sylabusin e lëndës literaturën bazë dhe ndihmëse dhe e evidenton në mbledhjen e departamentit ku miratohen sylabuset e lëndëve. Revista “Buletini Shkencor” që publikon artikujt dhe studimet shkencore të pedagoqeve, shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët. Nevojat e studentëve për literaturë mbështetëse ofrohet edhe nga Biblioteka e USH-së, e pasuruar së fundmi me libra të fushës psiko-sociale në kuadrin e projektit T@ask.

USH-ja kontribuon në përmirësimin e jetës studentore dhe plotësimin e saj me aktivitete ekstrakurrikulare. Angazhimi i studentëve në punë vullnetare dhe nisma bamirësie janë një praktikë e mirë e realizuar prej vitesh dhe është kthyer në traditë për USH-në, që gjithashtu, hedh bazat e punësimit të studentëve pas diplomimit përmes bashkëpunimit me institucione të ndryshme të rajonit. Në favor të punësimit të studentëve është edhe USH-ja, sepse shumë ish-studentë të USH-së janë tashmë pjesë e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitet.

Analiza SWOT

Pika të forta

- USH-ja është institucioni publik i arsimit të lartë i vetëm në zonën e Veriut të Shqipërisë;
- Universiteti ofron programe akademike bashkëkohore, kurrikula në përputhje me kërkesat e tregut dhe të reformuara në zbatim të Deklaratës së Bolonjës dhe udhëzimeve të MASR.
- Departamentet bëjnë përpjekje të vazhdueshme për hapjen e programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës;
- Raporte të mira dhe bashkëpunuese me institucionet publike dhe bizneset të cilat ndikojnë në përfshirjen e studentëve në praktikat profesionale;
- Përfshirjen e studentëve në vendimmarrje.
- Shkalla e lartë e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm dhe atij mbështetës;
- Cilësia e veprimtarisë së USH-së, garantohet nëpërmjet krijimit të NJSBC në nivel institucional, në nivel fakulteti dhe në nivel të njësive bazë, anëtarë të këtyre grupeve janë studentë dhe ekspertë të jashtëm. Gjithashtu është krijuar komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe në programet e studimit;
- Politika mbështetëse ndaj studentëve të kategorive sociale të veçanta;
- Ndërkombëtarizimi: USH-ja ka nënshkruar disa marrëveshje me universitetet brenda dhe jashtë vendit. Janë realizuar mobilitete të stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve si dhe janë siguruar bashkëpunime me strukturat kërkimore brenda këtyre universiteteve duke realizuar aktivitete të përbashkëta, si: publikime, konferenca, projekte si dhe bashkëpunim në drejtim të realizimit të programeve të studimit etj;
- Bashkëpunim i mirë mes departamenteve të fakulteteve në realizimin e programeve të studimit sipas raporteve të përcaktuara (pedagog i brendshëm-pedagog i jashtëm);
- Nivel i mirë i punës kërkimore shkencore të pedagogëve;
- Transparenca dhe informacionet e vazhdueshme dhe të aksesueshme në faqen web të Universitetit;
- Aplikim i modeleve të reja dhe bashkëkohore të mësimdhënies;
- Informimi i vazhdueshëm i studentëve si dhe përfshirje e studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter akademik, social, kulturor dhe sportiv;
- Literaturë bashkëkohore dhe e pasur që u ofrohet studentëve;

Pika të dobëta

- Mungesa e decentralizimit të autonomisë financiare në rang departamenti dhe fakulteti;
- Pamjaftueshmëri ambientesh për zyra për stafin akademik;
- Mospasja e vazhdueshme e studentëve të huaj në programe të studimit për të krijuar një ambient të diversifikuar social dhe shkëmbimi eksperiencash studentore;
- Infrastruktura jo plotësisht e përshtatur për studentët me aftësi të kufizuara;
- Numër jo i mjaftueshëm i studentëve në ciklin e dytë të studimit dhe nivel i ulët i përfshirjes së tyre në veprimtari kërkimore shkencore;

Mundësitë

- Zgjerimi i bashkëpunimit me organizatat e huaja qeveritare dhe joqeveritare që operojnë në vend;
- Pozicioni gjeografik i USH-së ofron mundësi për përthithjen e studentëve të rajonit dhe më gjerë si dhe për shkëmbim përvojash në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor;
- Bashkëpunimi midis institucioneve të arsimit të lartë në vend dhe jashtë tij, përbën një mundësi për shkëmbim eksperience, ekspertize, informacioni, dijes, teknologjish dhe burimesh njerëzore, por njëkohësisht ajo shërben edhe si një mundësi për përmirësim të vazhdueshëm;
- Mundësia e dhënies të mbështetjes financiare nga organizma të ndryshëm për studentët më të mirë në fakultete;
- Kualifikimi i vazhduar i stafit akademik mbi metodologjinë e projekteve, teknologjinë e informacionit dhe metodikën e mësimdhënies, për përmirësimin e cilësisë së brendshme si dhe veprimtarisë akademike kërkimore, shkencore dhe mësimore të programeve të studimit;

Kërcënimet

- Prirja e maturanëve për të vazhduar studimet universitare jashtë shtetit, gjë që sjell reduktimin e numrit të studentëve në USH.
- Rënie e mundësive të punësimit të të diplomuarve gjatë periudhës së Covid-19 si pasojë e ndikimit në ekonomi;
- Ndryshimet demografike;
- Tregu i punës është i pakonsoliduar dhe i pabazuar në meritokraci, gjë që ul vlerën e diplomës studentëve të mirë.
- Numri i ulët i studentëve që duan të frekuentojnë disa nga programet e studimit që ofron USH-ja;
- Preferencë jo e lartë e maturanëve për disa programe studimi, në veçanti për programet e mësuesisë;
- Mungesa e një tregu të gjerë punësimi në nivel rajonal, mungesa e të dhënave mbi punësimet në nivel rajonal e më gjerë krijon vështirësi në orientimin e programeve të studimit dhe në përcaktimin e kuotave për çdo program;

Shtojca nr.1

Pyetësor mbi sekretaritë mësimore


Pyetjet

	Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
Punonjësit e sekretarive janë të qartë për rolet dhe përgjegjësitë e tyre.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Punonjësit e sekretarive i shtojnë vlerë universitetit.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Punonjësit e sekretarive kanë sjellje profesionale në punë.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Jam ndjerë i mirëpritur nga stafi i sekretarisë.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Kam marrë zgjidhje të shpejtë për problemet lidhur me sekretaritë mësimore.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Komunikimi me punonjësit e sekretarive është i kënaqshëm.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Punonjësit e sekretarive kanë aftësi të mira për zgjidhjen ose orientimin e problematikave.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Standardet etike dhe të mbarëvajtjes së punës janë të përcaktuara qartë dhe respektohen.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Bashkëpunimi me punonjësit e sekretarive është përvojë e kënaqshme.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Sekretaritë mësimore kanë personelin e nevojshëm për të mbuluar nevojat e studentëve.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Punonjësit e sekretarive respektojnë orarin e pritjes së studentëve.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Punonjësit e sekretarive respektojnë orarin e punës.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Punonjësit e sekretarive na asistojnë shumë gjatë sezonit të provimeve në lidhje me regjistrimin në provim.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Analiza e pyetësorit

Në muajin maj 2021 është realizuar pyetësori online për sekretaritë mësimore. Pyetësori është hartuar nga zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe vlerësimit të standardeve dhe u është shpërndarë të gjithë studentëve në adresat e tyre të e-mailit që kanë paraqitur në momentin e regjistrimit në USH. Pyetësorit i janë përgjigjur vetëm 102 studentë.

Përshtypjet në lidhje me shërbimin e sekretarise



Pohimet:

1. Punonjësit e sekretarive janë të qartë për rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
			92(90%)	10(10%)

2. Punonjësit e sekretarive i shtojnë vlerë universitetit.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
			82(80%)	20(20%)

3. Punonjësit e sekretarive kanë sjellje profesionale në punë.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
			87(85%)	15(15%)

4. Jam ndjerë i mirëpritur nga stafi i sekretarisë.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
5(5%)			82(80%)	15(15%)

5. Kam marrë zgjidhje të shpejtë për problemet lidhur me sekretaritë mësimore.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
			102(100%)	

6. Komunikimi me punonjësit e sekretarive është i kënaqshëm.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
			102(100%)	

7. Punonjësit e sekretarive kanë aftësi të mira për zgjidhjen ose orientimin e problematikave.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
			102(100%)	

8. Standardet etike dhe të mbarëvajtjes së punës janë të përcaktuara qartë dhe respektohen.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
				102(100%)

9. Bashkëpunimi me punonjësit e sekretarive është përvojë e kënaqshme.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
			102(100%)	

10. Sekretaritë mësimore kanë personelin e nevojshëm për të mbuluar nevojat e studentëve.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
	10(10%)		92(90%)	

11. Punonjësit e sekretarive respektojnë orarin e pritjes së studentëve.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
	10(10%)		82(80%)	10(10%)

12. Punonjësit e sekretarive respektojnë orarin e punës.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
			102(100%)	

13. Punonjësit e sekretarive na asistojnë shumë gjatë sezonit të provimeve në lidhje me regjistrimin në provim.

Aspak dakord	Nuk jam dakord	Neutral	Jam dakord	Shumë dakord
				102(100%)

Siç shihet edhe nga pohimet shumica e studentëve kanë përshtypje të mira për shërbimet që ofrojnë sekretaritetë.

Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së

(Të renditura në përputhje me dhe sikurse janë referuar në raportin e vetëvlerësimit)

Evidenca	Përshkrimi
1.1	Vendimi i Bordit të Akreditimit
1.2	Vendim i SA për shpërndarjen e fondit për pjesëmarrjen në konferenca shkencore
1.3	Rregullorja e Senatit Akademik
1.4	Statuti i USH-së
1.5	Rregullorja e brendshme e administratës së Universitetit
1.6	Rregullore e fakulteteve
1.7	Rregullore e departamenteve
1.8	Rregullore e programeve të studimit
1.9	Rregullore e Bordit të Administrimit
1.10	Urdhër Rektorati nr.346, datë 04.11.2020 për krijimin e komisionit AD-HOC
1.11	Kodi i Etikës
1.12	Vendim Dekanati
1.13	Vendim Departamenti
1.14	Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit
1.15	NJSBC në nivel fakulteti dhe në nivel të programeve të studimit
1.16	Strategjia e zhvillimit 2017-2021
1.17	Plani strategjik për zhvillimin e programeve të studimit
1.18	Raporti i punës Mësimore-Shkencore realizuar nga departamenti
1.19	Raporti i vjetor i Fakultetit
1.20	Miratim i RVB-së për programet e studimit
1.21	Miratim i RVB-së së Fakultetit
1.22	Për miratimin e studentit anëtar në Komisionin për garantimin e standardeve të cilësisë në USH
1.23	Strategjia e Studimit të Tregut të Punës
1.24	Lista e programeve për të cilat është bërë aplikimi për akreditim
1.25	Studimi i tregut të punës nga departamentet
1.26	Strategjinë e ndërkombëtarizimit
1.27	Marrëveshjet e bashkëpunimit

1.28	Marrëveshje me institucione dhe organizata
1.29	Angazhim i personelit akademik në mësimdhënie jashtë vendi
1.30	Mobilitetet 2020-2021
2.1	Rregullore e zënies dhe e ruajtjes së vendit të punës
2.2	Model i rekrutimit të pedagogut efektiv
2.3	Shkresa për mbulimin e lëndëve nga fakultetet e tjera
2.4	Rregullore e Zyrës së Ekselencës
2.5	Tryezë e rrumbullakët, Korçë
2.6	Marrëveshje me OEAD
2.7	Udhëzuesi i platformes Teams
2.8	Strategjia e mësimdhënies
2.9	Pyetësor lidhur me programet e studimit
2.10	Miratim RVB
2.11	Miratimi i punës mësimore-shkencore në departament e në dekanat
2.12	Vendim Miratim Syllabuset 20-21
2.13	Vlerësim i performancës së pedagogëve
2.14	Foto në shtëpinë e fëmijëve Shkodër
2.15	Organika 2021
2.16	Projektbuxheti 2021-2023
2.17	Kërkesa e Fakultetit për projektbuxhetin 2021-2023
2.18	Projektraporti i hartuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm
2.19	Raportimi financiar janar-dhjetor 2020
2.20	SMAK
2.21	Rregullorja e programit ESSE3
2.22	Strategjia e komunikimit dhe e informimit publik
2.23	Laboratori i ri Informatik pranë FSHE-së
2.24	Planimetria FSHE
2.25	Stafi i BUSH

3.1	Guida për studentët e rinj
3.2	Rregullorja e studimeve në USH
3.3	Për miratimin e kriterëve të kandidatëve konkurrues për ciklin e parë të studimeve
3.4	Kuotat e pranimeve 2020-2021
3.5	LTEV-Lista e trajnimeve
3.6	Planet mësimore
3.7	Model Sylabusi
3.8	Fletëpalosje FSHE
3.9	Përmirësim programi mësimor
A	Pyetësori për mësimdhënien online
4.1	Lista e librave T@sk- Kontrate shtese
4.2	Udhëzime për proven finale
4.3	Datat e provimeve të semestrit të parë, viti akademik 2020-2021
4.4	Datat e provimeve të semestrit të dytë, viti akademik 2020-2021
4.5	Datat e riprovimeve të vjeshtës, viti akademik 2020-2021
4.6	Datat e provimit të diplomës për ciklin Bachelor, Master Profesional dhe Master Shkencor, sezoni i verës, viti akademik 2020 - 2021
4.7	Diploma suplement
4.8	Buxheti i vitit 2021
4.9	Marrëveshje me Institucione të huaja
4.10	Anëtarësimi i USH-së në Agjencinë Universitare të Frankofonisë(AUF)
4.11	Strategjia e kërkimit dhe e inovacionit
4.12	Projekti IDEA
4.13	Vendimi për miratimin e fushave prioritare
4.14	Njoftim për botimin e artikujve në Buletin
5.1	Datat e aplikimeve pranë IAL-së për vitin akademik 2020-2021
5.2	Listat paraprake të fituesve, viti akademik 2020-2021
5.3	Njoftim për zhvillimin e konkurseve të pranimit të studentëve
5.4	Faqja e Facebook

5.5	Orari i takimeve me studentët
5.6	Lista e tutorëve
5.7	Regjistrimi online i studentëve në provime
5.8	Platforma e komunikimit nëpërmjet programit LMS dhe Moodle
5.9	Fatura arkëtimi për tarifat vjetore, viti akademik 2020-2021
5.10	Formulari i aplikimit për përfitim burse
5.11	Diplome Bachelor
5.12	Këshilli Studentor Institucional
5.13	Kërkesë drejtuar Rektorit të USH-së
5.14	Kthim përgjigjeje kërkesës së studentëve të Këshillit Studentor të USH-së
5.15	Bashkëpunim me ECO MENDJE